Prauon me dt.:
26/11/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.480/26

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mentor Hajraj - kryetar, Xhevdet Abazi dhe Arben Hoti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Riad Merovci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve Naim Murseli nga fsh. Bërnicë, Komuna e Prishtinës, Granit Plava nga fsh. Cërmjan, Komuna e Gjakovës dhe Kushtrim Kokalla, gjithashtu, nga fsh. Cërmjan, Komuna e Gjakovës, për shkak të veprave penale dhe atë: për të akuzuarin Naim Murseli, vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin Granit Plava, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, si dhe për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe veprës penale moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre nga neni 378 par. 1, pika 1.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar Leonard Ademaj, av. Leutrim Syla dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli, av. Shemsedin Pira dhe av. Teuta Zhinipotoku, Granit Plava, av. Skender Gojani dhe Kushtrim Kokalla, av. Ndrecë Dodaj, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.3/25 i datës 06.07.2026, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK-së, më datë 29.10.2026, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av. Leutrim Syla dhe mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, av. Shemsedin Pira, av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj, ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.3/25 i datës 06.07.2026, për të akuzuarin Naim Murseli, për veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin Granit Plava, për veprat penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, si dhe për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, vërtetohet.

Aktgjykimi i ankimuar, përkitazi me veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre nga neni 378 par. 1, pika 1.1 të KPRK-së, për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, pra, për pjesën refuzuese, mbetet i paprekur.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.3/25 të datës 06.07.2026, i ka shpallur fajtorë të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla dhe atë; të akuzuarin Naim Murseli, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin Granit Plava për veprat penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, dhe të akuzuarin Kushtrim Kokalla, për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar; të akuzuarin Naim Murseli, e ka gjykuar me dënim me burgim të përjetshëm në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 01.12.2023 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, të akuzuarin Granit Plava, e ka gjykuar me dënim me burgim të përjetshëm në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 01.12.2023 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, dhe të akuzuarin Kushtrim Kokalla me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vjet, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 01.12.2023 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, dënime këto të cilat do të ekzekutohen menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarve iu ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, ashtu që, të njëjtëve iu ka konfiskuar:

- Të akuzuarit Granit Plava, i konfiskohet arma e zjarrit e markës "Zastava" me ngjyrë të zezë me numër serik ET-991503 si dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) fishekë të kalibrit 6.35 m.m, një telefon i markës, Samsung me ngjyrë të zezë, modeli A14, me numër serik 354860640346085.

- Të akuzuarit Naim Murseli, i konfiskohen një Iphone 12 Pro (pa kod), me numër serik 356697110366492, mjetet monetare në shumën prej 1350 €, një DWR me numër serik 8LOFB16TADA6FS8.

- Të akuzuari Kushtrim Kokalla, i konfiskohet një Iphone 14 Pro Max, me numër serik MWN6Y1HP4H, IMEI: 355216221830337.

Të akuzuarit Naim Murseli Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, i ka obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor secilit veç e veç shumën prej nga 500 €, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, secili veç e veç, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar akuza e prokurorisë, kundër të akuzuarit Kushtrim Kokalla, për veprën penale moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre nga neni 378 par. 1, pika 1.1 të KPRK-së, me arsyetim se për veprën penale në fjalë, në seancën e shqyrtimit gjyqësor prokuroria është tërhequr nga akuza, përkitazi me këtë vepër penale për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, prandaj, edhe është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore DKR në Prishtinë, për shkak të vendimit për dënim, përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit Kushtrim Kokalla, t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, gjegjësisht, dënim me burgim të përjetshëm.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Leutrim Syla, për shkak të vendimit për dënim, përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, gjegjësisht, dënim me burgim të përjetshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit Naim Murseli, av. Shemsedin Pira, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, apo të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me burgim, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Granit Plava, av. Skender Gojani, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, apo edhe të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me burgim, se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Kushtrim Kokalla, av. Ndrecë Dodaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza apo të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, av. Shemsedin Pira e av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj, ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Leutrim Syla, me propozim që ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava të vërtetohet, ndërsa, përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla të veprohet sipas propozimit në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, të paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar, pra, të ndryshohet dhe të akuzuarit Kushtrim Kokalla t'i shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm.

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA E APELIT PRISHTINË APELACIONI SUD PRIŠTINA

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK-së, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarin Leonard Ademaj, përfaqësuesin e autorizuar të palës së dëmtuar, av. Leutrim Syla, të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla dhe mbrojtësit e tyre, av. Shemsedin Pira, av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm Prokuroria e Apelit - Prokurorja Ikramije Bojaxhiu, i dëmtuari, Leonard Ademaj, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. Leutrim Syla, të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, mbrojtësit e të akuzuarve av. Shemsedin Pira, av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj. Në seancën e kolegjit, pasi më parë, gjyqtari raportues bëri elaborimin e shkresave në lëndë, duke përfshirë aktgjykimin e ankimuar, ankesat dhe përgjigjet në ankesë, përkitazi me këtë çështje penalo-juridike, para se të vazhdohet me fjalën e palëve në procedurë, Gjykata e Apelit, vendosi që tani e tutje të vazhdohet me seancë të mbyllur për publikun, krejt kjo me qëllim të respektimit të privatësisë së palëve, që ka të bëjë me raportet personale të palëve në procedurë me palë të treta, arsye këto për të cilat edhe nga gjykata e shkallës së parë, ka qenë e mbyllur seanca në shqyrtimin gjyqësor për publikun, e që një vendim të tillë nuk e kundërshtuan as palët prezentë. Më tutje, në seancën e kolegjit të kësaj gjykate Prokurorja e Apelit, Ikramije Bojaxhiu, pasi më parë bëri elaborimin e tërësishëm të ankesës, por, edhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit, me shenjën PPA/Inr.418/26 të datës 14.09.2026, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në shkresat në fjalë, duke propozuar ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla, ashtu që, edhe këtij të akuzuari t'i shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, ndërsa, përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve propozojë që ato të refuzohen ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për pjesën tjetër të vërtetohet. Pastaj, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, po ashtu, pasi paraqiti përmbajtjen e ankesës por, edhe të përgjigjes në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, i propozoi gjykatës që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla, ashtu që, edhe këtij të akuzuari t'i shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, kurse, përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli dhe Granit Plava, propozoi që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar për këta të akuzuar të vërtetohet, të cilën e përkrahu edhe i dëmtuari Leonard Ademaj. Pastaj, mbrojtësit e të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, av. Shemsedin Pira e av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj, pasi më parë e bënë elaborimin e tërësishëm të pretendimeve ankimore nga ankesat e tyre i propozuan gjykatës që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, të cilët i përkrahën edhe të akuzuarit që ishin prezent në seancën e kolegjit, pra, të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla.

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/I.nr.418/2026 datë 14.09.2026, ka propozuar që të aprovohet ankesa e prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, si dhe ajo e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, ashtu që, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla dhe të akuzuarit në fjalë t'i shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, ndërsa, të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe aktgjykimi i ankimuar përkitazi me të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penale-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa dhe përgjigje të ankesave, gjeti se:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË
APELACIONI SUD PRIŠTINA
III/A

Ankesat e Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av. Leutrim Syla dhe ato të mbrojtësve të akuzuarve av. Shemsedin Pira, av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj, nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e kësaj gjykate.

Në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli, av. Shemsedin Pira, dhe av. Teuta Zhinipotoku, të paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, me arsyetim se së pari se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur arsyera lidhur me faktet vendimtare edhe ato pak arsyera që janë paraqitur janë në kundërthënie të plotë ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave në lëndë. Gjithëherë, sipas pretendimeve ankimore, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 10 e lidhur me nenin 369. par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, shkelje këto të cilat konsistojnë me faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, pastaj, i mungojnë arsyet për faktet vendimtare, gjegjësisht, ato që janë paraqitur kanë kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e tij dhe atë sidomos, përkitazi me faktin se a pati ndikim në privimin nga jeta të tani të ndjerës Liridona Ademaj, i akuzuari Naim Murseli, pra, a veproi në bashkëkryerje me të akuzuarin tjetër, ku, për faktet dhe rrethanat në fjalë gjykata e shkallës së parë, përveç, në dispozitiv që nuk ka përshkruar veprimet inkriminuese që përbëjnë elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë as në arsyetim nuk ka arritur të japë arsyera të mjaftueshme, e po ashtu, edhe përpilimi i aktgjykimit të ankimuar nuk është bërë konform dispozitave të nenit 369 të KPPRK-së, shkelje këto të gjitha të cilat aktgjykimin e ankimuar e bëjnë të paligjshëm. Më tutje, në ankesë pretendohet se aktgjykimi i ankimuar, nuk mund te qëndroj për shkak të shkeljeve të shumta të procedurës penale, të cilat janë bërë me rastin e procedimit të kësaj çështje penalo - juridike, ku, gjykata e shkallës së parë, përveç, që nuk ka marr parasysh propozimet mbrojtësve të akuzuarit Naim Murseli, duke refuzuar apriori të njëjtat, për t'u bërë rekonstruimi i vendit të ngjarjes, shikimi i video të komunikimit me fëmijët, në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka thënë asnjë fjalë të vetme përkitazi me refuzimet në fjalë, gjë që e njëjta është e obliguar, që palëve t'iu jep arsye konkrete të refuzimit të propozimit në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar gjë që gjykata e shkallës së parë nuk e ka bërë në rastin konkret dhe ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par 10 lidhur me dispozitat e nenit 369 par.7 të KPPRK-së. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e kundërshtuar ka bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 2, nën par 2.4 KPPRK-së, sepse nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës. Me këtë dispozitë ligjore synohet zgjidhja e aspektit kuantitativ të raportit ndërmjet akuzës dhe aktgjykimit duke detyruar gjykatën që me aktgjykim të zgjidh lëndën e akuzës në tersi, duke mos lënë pa zgjidh asnjë element të përmbajtjes së akuzës së paraqitur fillimisht përkatësisht të ndryshuar, të zgjeruar ose të plotësuar. Duke qenë se akuza dhe aktgjykimi duhet të jenë në pikëpamje të përmbajtjes ekuivalente gjykata detyrohet ta zgjidh lëndën e akuzës në tersi, duke përfshirë me aktgjykim të gjitha veprat penale dhe të gjithë të akuzuarit nga akuza e paraqitur ose eventualisht e ndryshuar në shqyrtimin gjyqësor. Asnjë pikë e akuzës nuk mund të jetë e

pa përfshirë në vet aktgjykimin, pra, aktgjykimi duhet ta zgjidh (të vendos për akuzën), as më shumë e as më pak nga ajo. Akuza e Prokurorisë Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, e ka ngarkuar të pandehurin Naim Murselin, për dy vepra penale me dy dispozitiva e cilësime të ndryshme për vrasje në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 pika 1.3, 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dispozitiv i parë, ku, për këtë vepër është dënuar me dënim burgu të përjetshëm, kurse, për dispozitivin nën II. të akuzës tani aktgjykimin lëndor të vrasjes në bashkëkryerje me Granit Plavën dhe atë, nga neni 173 par.1, pika 1.6 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në raport me të akuzuarin Naim Murseli, nuk ka vendos as nuk është refuzuar akuza e as nuk është aprovuar sepse nuk kemi dënim të shqiptuar, sipas dispozitivit II. të aktgjykimit, pra këtu ekziston shkelja e dispozitës së lartë cekur ligjore e që në rastin konkret kjo shkelje nuk mund të tejkalohet. Aktgjykimi i ankimuar nuk mund të qëndroj për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nën par 2.7 lidhur me nenin 369 par 7 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), ngase, me aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë, nuk i ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet të cilat i konsideron të vërtetuara për kryerjen e veprës penale në akuzë për të akuzuarin për të cilën e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 pika 1.3, e 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës penale qëndron në atë, sepse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është kundërthënës me arsyet e aktgjykimit, ndërsa, arsyet e dhëna në aktgjykim janë të paqarta dhe kundërthënëse në mes vete, përkatësisht, faktet të cilat i konsideron si të vërtetuara janë kundërthënëse me provat e administruara. Kështu që, me aktgjykimin e ankimuar nuk janë paraqit arsyet për faktet vendimtare dhe se për ato po ashtu ekziston kundërthënia në mes të atyre të cilat janë paraqit në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar me përmbajtjen e shkresave dhe provave të adminstruara në këtë çështje penale. Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është kundërthënëse me përmbajtjen e shkresave sepse nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare përkitazi me veprimet e kryesit të akuzuarit Naim Murseli, lidhur me kryerjen e veprës penale - vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Në faqen 121 të aktgjykimit, në fund të pasuesit të parë thuhet se gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale siç janë ngarkuar sipas aktakuzës së prokurorisë, kështu duke e forcuar bindjen se është vërtetuar dashja e pa kompromis e të akuzuarve për të kryer veprën penale në bashkëkryerje. Ky konstatim është totalisht i gabueshëm sepse i akuzuari Kushtrim Kokalla, është shpall fajtor për shkak të veprës penale- ndihma në kryerjen e veprës penale - vrasje e rëndë nga neni 173 par 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, e jo pra, të veprës penale të vrasjes në bashkëkryerje. Kundërthënia në mes të përmbajtjes së dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit rezulton edhe në atë, se në faqen 122 të aktgjykimit në mesin e pasuesit të 2 gjendet edhe ky konstatim, "Ndërkaq që vrasja e anëtarit të familjes në mënyrë dinake, e paraprirë nga ndihma e të akuzuarit të dytë me gjetjen e vrasësit dhe e finalizuar nga i akuzuari i tretë me vrasje në mënyrë të paskrupullt, në sy të fëmijëve të saj për shpërblim me dobi pasurore janë motivet më të ulta që një qeneje në formë të njeriut mund t'i ndërmarr ". Ky konstatim i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim të padiskutueshëm sepse nuk përkon me dispozitivat e hartuar nga gjykata sepse në ato, paraqitet një gjendje krejtësisht tjetër e që është në kundërshtim të thellë me këtë konstatim, pra një konstatim plotësisht i gabuar i cili nga përmbajtja e cekur sjell shumë dyshime dhe dilema të cilat në një situatë siç është përpiluar nuk mund të tejkalohet. Ky konkludim është i paakceptueshëm në rrethanat se si ka rrjedhë procedura penale dhe të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë. Arsyet e dhëna nga aktgjykimi i ankimuar janë të paqarta ngase, ekziston kontradiktë e theksuar midis asaj që paraqitet në arsyet e aktgjykimit të cilat kundërthënie janë kontradiktore me përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve dhe përfundimet e nxjerra nga ana e gjykatës në këtë aktgjykim janë në kundërshtim me

provat e administruara, e të cilat sjellin në një përfundim tjetër. Analiza e provave nga ana e gjykatës në aktgjykimin e ankimuar është e përgjithësuar, mungesa e një analize të tillë në këtë dimension paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe aktgjykimi i ankimuar nuk mund të qëndrojë, meqenëse, përfundimet e gjykatës janë në kundërshtim me rezultimet nga provat e administruara në shqyrtimin kryesor në këtë çështje penale kundër të akuzuarit Naim Murseli. Nuk janë kontestuese autorizimet e gjykatës të cilat sipas vlerësimit të vet, mund të provoj dhe të marr parasysh çdo provë të pranueshme dhe ka autoritetin që t'i vlerësoj të gjitha provat e parashtruara. Pra vlerësimi i gjykatës është veprim konkret që konkludimet e nxjerra mbi bazën e provave të administruara në shqyrtimin kryesor duke i paraprirë vlerësimi i pranueshmërisë së secilës provë veç e veç, vlerësimi i secilës provë me aktgjykimin e ankimuar nuk është i orientuar në atë, se cili fakt provohet me të apo, cili fakt kontestohet, e që mungesa e një analize të tillë në aktgjykimin e ankimuar paraqet shkelje thelbësore (apsolute) të dispozitave procedurale që për pasojë tërheq anulimin e aktgjykimit pa u lëshuar në trajtime tjera. Mungesa e arsyetimit të këtyre fakteve dhe rrethanave e bëmë ligjërisht aktgjykimin të ankimuar ndaj të akuzuarit Naim Murseli të paqëndrueshëm ngase aktgjykimi i ankimuar është kontradiktor me faktet provat dhe bazën ligjore. Njëkohësisht mbrojtësit e të akuzuarit Naim, theksojnë se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk ka bërë analizën e provave veç e veç dhe nuk janë arsyetuar faktet në plotni i besimit apo jo të deklarimeve duke mos bërë analizë të arsyeve, por vetëm nxjerrjen e konstatimeve steriotipe të fjalive që në vete nuk përmbajnë arsyet pse i falet besimi një prove, e pse jo provës tjetër. Kjo është e barasvlershme me mungesën e arsyetimit ligjor sipas kërkesës ligjore dhe mbi këtë bazë aktgjykimi dënues i ankimuar nuk mund të qëndrojë. Të drejtat themelore prezumimi i pafajësisë dhe barra e të provuarit janë të artikuluara me të gjitha konventat kryesore ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe janë të përcaktuara në nenin 3 të KPPRK-së, prezumimi i pafajësisë i të pandehurit "in dubio pro reo". Kjo nënkupton se barra e provës se i akuzuari është fajtor për veprën për të cilën akuzohet i përket gjithnjë prokurorisë, se i akuzuari nuk është i detyruar ta pranoj fajësinë e tij, e meqë, i akuzuari të gjendet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë gjykata duhet të gjej se akuzat e ngritura nga prokuroria janë provuar nga gjykata përtej dyshimit të arsyeshëm. Në rastin konkret nuk ekziston provë e pakontestueshme e cila do të kishte ndërlidh veprimet e të akuzuarit me elementet qenësore të veprës penale për të cilën është dënuar dhe për këtë nuk është dhënë asnjë arsyetim përkatës, për çfarë edhe aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nën par. 7 e lidhur me nenin 369 të KPRK-së, prandaj, si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, propozon që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Granit Plava, av. Skender Gojani, të paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, me arsyetim se së pari se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur arsyera lidhur me faktet vendimtare edhe ato pak arsyera që janë paraqitur janë në kundërthënie të plotë ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave në lëndë. Gjithherë, sipas pretendimeve ankimore, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 10 e lidhur me nenin 369 . par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, shkelje këto të cilat konsistojnë me faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, pastaj, i mungojnë arsyet për faktet vendimtare, gjegjësisht, ato që janë paraqitur kanë kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që

paraqitet në arsyetimin e tij dhe atë sidomos, përkitazi me faktin se a u vërtetua identiteti i të akuzuarit Granit Plava, si person që ka shtënë me armë zjarri në tani të ndjerën Liridona Ademaj, ku, për faktet dhe rrethanat në fjalë gjykata e shkallës së parë, përveç, në dispozitiv që nuk ka përshkruar veprimet inkriminuese që përbëjnë elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë, as në arsyetim nuk ka arritur të japë arsyera të mjaftueshme, e po ashtu, edhe përpilimi i aktgjykimit të ankimuar nuk është bërë konform dispozitave të nenit 369 të KPPRK-së, shkelje këto të gjitha të cilat aktgjykimin e ankimuar e bëjnë të paligjshëm. Më tutje, në ankesë vazhdohet me pretendimin se mbrojtja e kundërshton aktgjykimin në tërësi në pjesën që ka të bëjë me pikëpamje të përgjegjësisë penale, ashtu edhe në pikëpamje të sanksionit penal, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit të gabuar mbi sanksionin penal, për çka, mbrojtja, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka theksuar mungesën e provës së drejtpërdrejtë që Granit Plava është personi që ka shtënë, e që për këtë mungon dëshmitari okular që e identifikon atë si ekzekutues, pastaj, mungesën e individualizimit forenzik të personit që ka shtënë dhe mungesën e verifikimit të kontradiktave përmes provave të tjera, pretendime këto që janë konstatuar edhe në vetë aktgjykimin, por, nuk kanë marrë përgjigje të plotë dhe bindëse. Veçanërisht, mbrojtja kundërshton me vendosmëri dënimin me burgim të përjetshëm, ngase, neni 173 paragrafi 1 i KPRK-së, nuk e përcakton burgimin e përjetshëm si dënim automatik, ai parasheh alternativën "jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose burgim të përjetshëm", ndërsa, neni 41 e rezervon burgimin e përjetshëm për veprat më të rënda të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose me pasoja shumë të rënda, ndërsa neni 42 paragrafi 2 lejon, për të njëjtën kategori veprash, burgim deri në tridhjetë e pesë (35) vjet. Përzgjedhja e burgimit të përjetshëm kërkon, rrjedhimisht, arsyetim të individualizuar pse as 35 vjet nuk mjaftojnë për Granit Plavën. Aktgjykimi nuk e jep këtë arsyetim, për çka, pretendimet e kësaj ankese janë ngritur dhe janë bërë objekt shqyrtimi në gjykatën e shkallës së parë. Vetë Aktgjykimi konstaton propozimin për rikonstruksion dhe refuzimin e tij (faqja 59), ndërsa, në faqet 62-64 përmbledh kundërshtimet e mbrojtjes së Granit Plavës lidhur me mungesën e individualizimit forenzik, mangësitë e ekspertizave dhe kërkesën për super ekspertizë. Pretendimi për presion dhe gjendje të rënduar gjatë deklarimit policor është ngritur nga i akuzuari në seancën e datës 26.03.2026. Në pjesën që lidhet me provat e administruara, ankesa nuk përsërit në mënyrë të përgjithshme kundërshtimet paraprake ndaj aktvendimit të datës 26.03.2025, por, kundërshton mënyrën se si këto prova janë vlerësuar dhe arsyetuar në aktgjykimin përfundimtar, për rrjedhojë, kërkesat janë të shqyrtueshme edhe në kuptim të nenit 382 paragrafi 4 të KPPRK-së, veçanërisht lidhur me identitetin e personit që ka shtënë, marrëveshjen e pretenduar për 30.000 €, rolin individual të Granit Plavës dhe dinamiken fizike të ngjarjes, fakte këto dhe rrethana që nuk janë shqyrtuar në mënyrë të mjaftueshme. Pastaj, kur, është fjala për standardin e të provuarit, gjykata përdor standardin "përtej dyshimit të bazuar mirë" - standard që KPP-ja e definon si bazë për ngritjen e aktakuzës në faqen 72 të aktgjykimit, kur, gjykata konstaton faktet vendimtare kundër Granit Plavës, përdor shprehimisht formulimin "është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Granit Plava...". I njëjti formulim përdoret edhe për veprën e armës dhe në pjesë të tjera të arsyetimit. "dyshimin e bazuar mirë", e që kjo nuk është vetëm çështje terminologjike, ngase, neni 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 i KPPRK-së e përkufizon mirë" si bazën për ngritjen e aktakuzës, neni 234, po ashtu, e lidh këtë standard me vendimin e prokurorisë për ngritjen e aktakuzës, pra, vetë Kodi e vendos këtë standard në fazën akuzuese, jo si standard të mjaftueshëm për një aktgjykim dënues. Kur, një gjykatë, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, deklaron se faktet vendimtare janë "vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë" krijohet një paqartësi thelbësore nëse është aplikuar pragu i duhur i provueshmërisë, pra, nuk mund të jetë thjesht konfirmim se ekziston baza që ka lejuar ngritjen e aktakuzës, mirëpo, jo edhe e mjaftueshme për ta shpallur fajtor të akuzuarin.

Kjo shkelje është veçanërisht serioze sepse nuk shfaqet vetëm në një fjali të aktgjykimit, ku, gjykata thotë se ka vërtetuar se Granit Plava, ka dal me maskë dhe ka shtënë në drejtim të tani të ndjerës edhe për shkak të premtimit të shumës prej 30.000 €, fakte këto dhe rrethana që nuk janë vërtetuar, e që për pasojë, Gjykata e Apelit, duhet të verifikojë nëse trupi gjykues ka vendosur fajësinë mbi standardin e nga parimet e nenit 1, nenit 3, nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, apo, në praktikë ka përdorur provueshmërinë e standardit të aktakuzës. Në një rast ku shqiptohet burgimi i përjetshëm, paqartësia për standardin e provueshmërisë nuk mund të konsiderohet e parëndësishme, pastaj, moszbatimi i plotë i parimit "In Dubio Pro Reo", që kërkon që mëdyshjet lidhur me faktet e rëndësishme të interpretohen në favor të akuzuarit, në rastin konkret, ekzistojnë mëdyshje të dokumentuara për identitetin e personit, mënyrën e saktë të realizimit të shtënies, pozicionet e personave në veturë, mënyrën e shkaktimit, lëndimet e shkaktuara me dorën e viktimës, komunikimet para ngjarjes dhe përmbajtjen e marrëveshjes së pretenduar, faktet dhe rrethana të gjitha këto që nuk janë vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, prandaj, pavarësisht, që arma e lidhur balistikisht me predhën është gjetur më vonë në shtëpinë e Granit Plavës, pra, e vërteton posedimin e sajë, por, nuk identifikon vetvetiu dorën që e ka përdorur dhe ka shtënë" prandaj, nuk do të thotë se "ai patjetër është personi me maskë", fakte këto të cilat duhet të jenë të provuara e jo të supozuara, prandaj, me aktgjykimin e ankimuar nuk është dhënë përgjigje e plotë, përkitazi me pretendimin e identifikimit të personit që ka shtënë ditën kritike, për çka, edhe në faqet 62-64 të aktgjykimit, ku, janë përmbledhur pretendimet e mbrojtjes, se asnjë dëshmitar nuk e ka parë atë si autor, pra, Granit Plavën, duke shtënë dhe se nuk ekziston provë okulare, teknike apo forenzike që e individualizon dhe vërteton se i akuzuari Granit Plava, ka shtënë ditën kritike, e që, këtë e kërkon edhe neni 369 par. 2 i KPPRK-së, ku, kërkohet vlerësimi me ndërgjegje i çdo prove, veç e veç dhe në lidhje me provat dhe bazuar në to e bënë përpilimin e arsyetimit të aktgjykimit, ndërsa neni 384 paragrafi 2.7 e trajton si shkelje esenciale, kur, çështjet në fjalë nuk merren parasysh nga gjykata. Prandaj, në rastin konkret mungon analiza e drejtpërdrejtë se Graniti, është personi me maskë që ka shtënë, kur nuk dihet se kush e ka identifikuar personin me maskë, me cilën provë forenzike është vërtetuar identiteti i personit që ka përdorur armën, e me këtë mungesa e kontestuar e rikonstruksionit të vendit të ngjarjes - mangësi esenciale për një rast me dinamikë, çështje kjo e ngritur edhe në shqyrtimin gjyqësor e jo vetëm tani me ankesë, e që neni 148 i KPPRK-së, e parashikon këqyrjen dhe rikonstruksionin për qartësimin e fakteve të rëndësishme, për shqyrtimin e provave dhe rikonstruksionin kur, kjo pas ngritjes së aktakuzës, kërkohet nga palët, e kryetari i trupit gjykues mund ta urdhërojë, e që kjo është e nevojshme për vërtetimin e plotë të fakteve relevante, sipas rasteve paraqet pikërisht situatën për të cilën ekziston ky instrument procedural. Me rikonstruimin e vendit të ngjarjes do të mund të vërtetohej, ndër të tjera, pozicionin real të viktimës në ulëse dhe këndin e kokës së saj në raport me dritaren, lartësinë dhe pozicionin e personit jashtë veturës për të mundësuar trajektoren e konstatuar mjekoligjore, distancën 2-5 cm nga gryka e armës deri te zona e hyrjes së predhës dhe nëse kjo përputhet me përshkrimin e ngjarjes, pozitën e të akuzuarit Naim Murselit dhe pretendimin se ai e mbante viktimën për dorën e majtë, si dhe lidhjen me lëndimin e konstatuar në atë dorë, pozicionin e fëmijëve dhe fushën e tyre të shikimit, pozicionin, lartësisë, veshjen dhe mundësinë e identifikimit të personit të maskuar, kohën e nevojshme për ndalimin e veturës, ofrimin, komunikimin, shtënien dhe largimin, përputhjen e dëshmive të ndryshme me provat fizike, sipas nenit 148 paragrafi 4 që parashikon rikonstruksion të veçantë, kur, dëshmitarët i paraqesin faktet ndryshe, fakte këto dhe rrethana të gjitha të cilat nuk janë vërtetuar, kurse, rikonstruksioni ishte propozuar dhe refuzuar, atëherë, aktgjykimi duhej të jepte arsye konkrete, pse skenari fizik mund të konsiderohej i vërtetuar pa këtë rikonstruim, sidomos, kur identiteti i personit të maskuar, pozicionet e personave dhe mekanika e shtënies ishin të kontestuara.

Mungesa e një arsyetimi të tillë është relevante si për vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike, ashtu edhe për kontrollin e ligjshmërisë së aktgjykimit, prandaj, nëse aktgjykimi nuk ndryshohet me lirim nga akuza dhe Gjykata e Apelit, vlerëson se mangësia nuk mund të korrigjohet drejtpërdrejt, mbrojtja kërkon kthimin e lëndës në rigjykim me udhëzim për rikonstruksion, me pjesëmarrjen e ekspertit mjeko-ligjor dhe ekspertit balistik, në mënyrë që dinamika e pretenduar të vlerësohet objektivisht. Po ashtu, nuk janë marr parasysh pretendimet përkitazi me deklaratat e dhëna në polici, ku, i akuzuari Granit Plava, deklaron se nuk qëndron pranë deklaratës së dhënë në polici dhe se ajo ishte bërë në marrëveshje me Naimin dhe nën presion të policëve", ai po ashtu deklaroi se mbrojtësi kishte parë gjendjen e tij emocionale dhe fizike dhe se ishte thirrur ndihma e shpejtë, e cila i kishte dhënë injeksion dhe një tabletë, kjo çështje, rrjedhimisht, është ngritur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nuk përbën pretendim të ri në Gjykatën e Apelit, ku neni 251 paragrafët 4-6 të KPPRK-së, ndalojnë ndikimin mbi lirinë e të akuzuarit për të formuluar dhe shprehur mendimin përmes keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, shtrëngimit ose veprimeve që dobësojnë kujtesën apo aftësinë për të kuptuar, kur marrja në pyetje bëhet në kundërshtim me këto ndalesa, procesverbali është i papranueshëm. Mbrojtja nuk kërkon që Gjykata e Apelit ta shpallë automatikisht deklaratën të papranueshme vetëm mbi bazën e pretendimit të akuzuarit Granit Plava, ngase, pretendimi ynë është proceduralisht më themelor, kur, një deklaratë e hershme është një hallkë qendrore e zinxhirit fajësues dhe i akuzuari në gjykim pohon presion dhe gjendje të rënduar që ka kërkuar ndërhyrje mjekësore, gjykata duhet ta hetojë seriozisht vullnetaritetin, gjendjen psikofizike, dokumentacionin mjekësor dhe rrethanat konkrete të marrjes në pyetje. Nëse ky verifikim nuk bëhet, deklarata nuk mund të përdoret si "çelës" për ti dhënë kuptim fajësues të gjitha provave të tjera rrethanore. Çdo, dyshim mbi vullnetaritetin dhe aftësinë e plotë të akuzuarit për të kuptuar deklarimin duhet të vlerësohet në lidhje me nenet 3, 7, 10 dhe 251 të KPPRK-së. Po ashtu, edhe përkitazi me gjendjen psikike të akuzuarit, ishte kërkesa e mbrojtjes për ekzaminim që ka rëndësi të drejtpërdrejtë për ligjshmërinë e burgimit të përjetshëm, e që me aktgjykimin e ankimuar është trajtuar deklarata e ekspertit Dr. Bujar Obertinca dhe konstatimi i tij, se te Granit Plava nuk është evidentuar çrregullim mendor, kronik apo akut, ose element psikik që do të ndikonte në përgjegjësinë penale, e që mbrojtja nuk kërkon që ky përfundim të zëvendësohet vetëm mbi bazën e një pretendimi të akuzuarit, për çka, gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e sajë në faqet 62-64 konstaton se mbrojtja kishte kundërshtuar plotësinë dhe metodologjinë e ekspertizave dhe kishte kërkuar super ekspertizë, duke iu referuar edhe aksidentit të rëndë të komunikacionit para ngjarjes dhe pasojave të pretenduara shëndetësore, e që çështjet në fjalë, për mbrojtjen kanë rëndësi sepse neni 41 paragrafi 3 i KPRK-së, ndalon burgimin e përjetshëm për personin i cili, në kohën e kryerjes së veprës, ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore, ndërsa neni 18 paragrafi 2 kërkon që aftësia e zvogëluar mendore të merret parasysh gjatë caktimit të sanksionit, prandaj, mbajtja në fuqi e burgimit të përjetshëm, duhet të jetë e kontrollueshme dhe se këto çështje të jenë të shqyrtuara plotësisht, që do të thotë se kërkesa për ekspertizë plotësuese ose super ekspertizë paraqitet vetëm në mënyrë subsidiare, nëse Gjykata e Apelit, konstaton se kundërshtimet metodologjike dhe dokumentacioni shëndetësor nuk kanë marrë përgjigje të mjaftueshme dhe se kjo mangësi mund të ketë ndikuar në përgjegjësinë ose llojin e dënimit. Pastaj, kur, është fjala për vlerësimin selektiv të deklaratave të bashkakuzuarve aktgjykimi u jep peshë të konsiderueshme deklaratave të hershme të akuzuarve, ndërkohë, që gjatë shqyrtimit gjyqësor janë paraqitur versione të tjera dhe kundërshtime substanciale, ngase, në një çështje me disa të bashkakuzuar, secili me interes të drejtpërdrejtë në pozicionin e vet procesual, deklaratat duhet të analizohen me kujdes të shtuar dhe të kërkohet konfirmim i jashtëm për çdo fakt vendimtar dhe nuk mjafton të thuhet se deklaratat "përshtaten me lëvizjet e veturave ose me faktin se arma ekzistonte", por duhet të provohet konkretisht se

pjesa e deklaratës që identifikon Granitin si ekzekutues dhe pjesa që flet për 30.000 € janë të mbështetura nga prova të pavarura, për ndryshe, krijohet rreziku që një deklaratë e kontestuar të shërbejë si konfirmim i një deklarate tjetër po ashtu, të kontestuar, sidomos deklarimi i Naim Murselit në shqyrtim, ku, personi që u paraqit se ishte i maskuar dhe me zë të ndryshuar, nuk mund të anashkalohet vetëm për shkak se një version më i hershëm ka qenë më kompatibil me tezën e akuzës. Gjykata duhej të shpjegonte pse versioni në sallën e gjykimit, i dhënë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të trupit gjykues dhe me mundësi pyetjesh, nuk krijon të paktën mëdyshje për identifikimin. Pastaj, provat elektronike dhe video-incizimet provojnë lëvizje, jo identitetin e ekzekutuesit dhe aktgjykimi i kushton hapësirë të konsiderueshme kamerave që regjistrojnë lëvizjen e BMW-së dhe Seat-it hyrje-daljet nga restoranti, mirëpo, këto janë prova të rëndësishme për kronologjinë dhe afërsinë hapësinore, por, nuk janë video të momentit të vrasjes dhe nuk tregojnë personin që ka shtënë në tani të ndjerën, nga fakti se një veturë e lidhur me Granit Plavën lëviz në një kohë të afërt me veturën e Naim Murselit, nuk mund të deduktohet pa hallka të tjera se çdo veprim i mëvonshëm i personit të maskuar është kryer nga Graniti, pra, provat rrethanore mund të ketë peshë të lartë vetëm kur zinxhiri është i mbyllur dhe nuk lë një mundësi tjetër alternative të arsyeshme dhe pikërisht mbyllja e këtij zinxhiri mungon në pjesën e identifikimit të personit që e njëjta vlen edhe për komunikimet në WhatsApp, ngase, mesazhet mund të provojnë kontakt dhe koordinim të caktuar, por, përmbajtja e tyre duhet interpretuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo me kuptim që buron vetëm pasi paraprakisht është supozuar se Graniti ishte ekzekutues, pastaj, mungesa e hetimit material të pagesës së pretenduar prej 30.000 €, për kualifikimin, që i përket fitimit të dobisë pasuror, e që është element qenësor i veprës penale për të akuzuarin Granit Plava, ku, nga materialet e cituara në aktgjykim nuk del një pagesë e realizuar, transfer bankar, dorëzim i dokumentuar i parave, burim i identifikuar i 30.000 €, apo gjurmë financiare që e lidhin Granitin me marrjen e kësaj shume, e që, një gjë e tillë mbështetet kryesisht në deklaratat e kontestuara të bashkakuzuarve, për çka, gjykata do duhej të identifikojë provat e pavarura që e vërtetojnë marrëveshjen e tillë, prandaj, si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, propozon që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Kushtrim Kokalla, av. Ndrecë Dodaj, të paraqitur kundër aktgjykimit të ankimuar, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, me arsyetim se së pari se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur arsyera lidhur me faktet vendimtare edhe ato pak arsyera që janë paraqitur janë në kundërthënie të plotë ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave në lëndë. Gjithherë, sipas pretendimeve ankimore, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 10 e lidhur me nenin 369 . par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, shkelje këto të cilat konsistojnë me faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, pastaj, i mungojnë arsyet për faktet vendimtare, gjegjësisht, ato që janë paraqitur kanë kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e tij dhe atë sidomos, përkitazi me faktet dhe rrethanat se ai ndihmojë i akuzuari Kushtrim Kokalla të akuzuarit tjetër Naim Murseli, në kryerjen e veprës penale të vrasjes, ku, në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar nuk kemi fare përshkrimin e veprimeve inkriminuese për këtë të akuzuar, pra, të akuzuarin Kushtrim Kokalla, e që do të përbënin elementet e veprës penale në fjalë, e që, për një gjë të tillë, as në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nuk janë dhënë arsyera të mjaftueshme, e po ashtu, edhe përpilimi i aktgjykimit të ankimuar nuk është bërë konform dispozitave të

nenit 369 të KPPRK-së, shkelje këto të gjitha të cilat aktgjykimin e ankimuar e bëjnë të paligjshëm, për çka, edhe e kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit në fjalë. Më tutje në ankesë, vazhdohet me konstatimin, se sipas logjikes se këtij aktgjykimi, nëse edhe dikush tjetër i njohur me te akuzuarit po te kishte qëlluar afër tyre ne ato takime me siguri do te ishte tani i dënuar si Kushtrim Kokalla. Sipas dispozitave ligjore nga nen 33 te KPRK-së, veprimet e ndihmës pasojën pasi qe ishte i ditur kryesi paraprakisht dhe veprimet lidhur me gjetjen e kryesit nuk janë veprime inkriminuese apo te dënueshme dhe nuk përfshihen ne veprime te ndihmës, cilat tani janë veprimet e tjera qe i i akuzuarii ka ndërmarrë për realizimin e kësaj vepre penale. Nëse gjykata ka menduar (apo nuk din t'i dalloje se si t'i kualifikoje veprimet e te akuzuarit Kushtrim) se i akuzuari ka vepruar diçka para se te vendos i akuzuari Granit për kryerjen e kësaj vepre penale, atëherë kemi te bëjmë me veprime te shtytjes e jo te ndihmës. Si do qe te jete ne asnjë mënyrë dhe ne asnjë interpretim ligjore nga praktika penalo juridike takimi siç e përshkruan si gjetje te kryesit gjykata, këtë veprim nuk e cilëson si veprim te ndihmës por as te shtytjes, pra, thjeshte këtu kemi te bëjmë me një interpretim te gabuar apo konstruktim juridik nga ana e gjykatës i pa dëgjuar gjere me tani. Nëse i besohet këtij konstrukti - interpretimi "juridik" te gjetjes, kjo, është sikur kur fillon ndërtimi i një objekti por pa bazament - themel, nëse i besohet se objekti mbahet pa themel, atëherë i besohet edhe ndihmës se pretenduar nga ana e gjykatës. Nëse këtë përshkrim faktik te këtij dispozitivi e krahasojmë me provat që vete gjykata i ka administruar, nuk është befasi se në shikim te pare te krijohet një huti se a kemi te bëjmë me një dispozitiv që ka te bëjë me përmbajtjen e arsyetimit apo kemi të bëjmë më një vepër krejtësisht tjetër. Provat formale si dhe ato materiale nga arsyetimi nuk vërtetojnë asgjë nga përshkrimi faktit i dispozitivit por janë në tersi në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit, në kundërshtim komplet me përshkrimin ligjor te kësaj vepre penale nga nen 33 i KPK-se. Mu për këtë potencova ma larte se dispozitivi i aktgjykimit është shume i zbrazet te le përshtypje se është edhe tepër parcial - si rrobat e arnuara për t'i dhënë formën e një veshje normale. Ne tere arsyetimin, gjykata vetëm bene bartje te dëshmive nga procesverbalet e shqyrtimeve gjyqësore apo deklaratave te dhëna ne hetuesi e asgjë me shume e te njëjta prova i përsërit edhe ne pjesën e aktgjykimit ku ka te beje me vlerësimin e provave nga fundi i aktgjykimit. Pra, aktgjykimi nuk ka arsyera të mjaftueshme për çështjet kryesore, arsyerat e dhëna në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë në kundërshtim me vetë - veten dhe me përmbajtjen e të gjitha shkresave të lëndës, përkatësisht, të deponimeve te dëshmitarëve dhe provave materiale. Të njëjtit, pra, aktgjykimit të ankimuar i mungojnë arsyerat për faktet vendimtare se kur janë dakorduar, ne cilin takim, si u dakorduan dhe ato që janë dhënë, janë të pamjaftueshme për të arsyetuar ashtu siç, kërkohet një dënim të tille. Në fakt, aktgjykimi i ankimuar, nuk përmban asnjë arsye për faktet vendimtare, gjykata, si u tha më lartë, në arsyetimin e aktgjykimit bënë përshkrimin e përmbajtjes provave të administruara në shqyrtimin gjyqësore, duke bërë transkriptimin e përmbajtjes së procesverbaleve mbi marrjen në pyetje të dëshmitarëve, të dëmtuarve, bënë disa konstatime lidhur me pyetje e përgjigje të palëve në procedure, bënë përshkrim të provave materiale, i referohet dhe e bënë përshkrimin e fjalës përfundimtare të palëve, por anashkalon detyrimin e gjykatës që lidhur me ato prova të veprojë në pajtim me kërkesat ligjore nga dispozitat e nenit 369 par. 7 të KPPK-së. Sa për qartësi po i referohem nen 369 par.7 i cili parashikon "Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit (vendimit të saj) paraqet qartë dhe në mënyrë të plot se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuar. Gjykata duhet të vërteton saktësinë e provave kundërthënëse (e ne ketë çështje penale ka me bollëk të tilla). Këto, kundërthënie dhe paqartësi, janë aq të theksuara ne aktgjykimin e atakuar se të njëjtin e bëjnë tërësisht të paqartë dhe juridikisht të paqëndrueshëm e të cilat kundërthënie paraqesin shkelje esenciale të dispozitave te nen.384 par.2 pika 2.7 e lidhur me nen 369 par.7 të KPPK-së.

Në rastin konkret nuk janë kontestuese shume veprime dhe fakte te natyrës objektive dhe subjektive qe kanë te bëjnë me te akuzuarin Kushtrim Kokalla, siç janë te tre te akuzuarit janë bashkëfshatar, i akuzuari Kushtrim, është ne lidhje familjare me te akuzuarin Naim (janë nip e daje), te tret janë nga i njëjti regjion dhe i njëjti fshat, përkatësisht i akuzuari Naim është edhe banorë i Prishtinës. Nuk është kontestues fakti se te tre te akuzuarit një muaj para natës kritike janë takuar tek pompa e benzinës "Shell" ne Prishtine, si dhe 4 - 6 dite para ndodhjes se vrasjes janë takuar tek pompa e benzines "Benita" ne udhëkryqin Peje - Gjakove - Kline. Sipas provave nga shkresat e lendes ne takimin e pare, ka qenë shume shkurt dhe nuk është biseduar asgjë qe ka te beje me veprën penale, ne takimin e dyte tek "Benita", ai takim është bere me kërkese te akuzuarit Naim dhe se aty i akuzuari Kushtrim, ka pranuar një shume te hollave prej 300 (treqind) € si pjese e kistit te kredisë qe kishte për te paguar pasi qe i njëjti kishte marre kredi dhe i kishte dhënë ato te holla Naimit, nga këto takime dhe bisedat e mundshme që janë zhvilluar vetvetiu a paraqesin veprime inkriminuese për te akuzuarin Kushtrim te cilat veprime përbejnë ndonjë elemente qe formësojnë figurën e veprës penale, për këtë, të tre te akuzuarit, japin versionin e tyre lidhur me ato takime, i akuzuari Granit, fillimisht ne intervestimin e tij ne polici me datën 01.12.2023 pohon se me te akuzuari Naim njihet qe 10-15 vite nga se janë bashkëfshatar dhe ne asnjë moment nuk e involvon te akuzuarin Kushtrim, ne ndonjë veprim te ndihmës për kryerjen e kësaj vepre penale, çka, pohon se për këtë çështje ka biseduar vetëm me Naimin dhe nuk e din fare se Kushtrimi a është ne dijeni pos qe potencon se me Kushtrimin është takuar vetëm një nate para natës kritike, e i cili për atë takim nuk ka cekur kurrfarë arsye se pse janë takuar dhe ku janë takuar. Me dt.14.12.26, ne një intervistim te serishëm nga ana e policisë lidhur me këtë rast, i njëjti i akuzuari jep një version krejtësisht tjetër se si janë takuar me Naimin, se me Naimin e ka njoftuar i akuzuari Kushtrim, pastaj, vazhdon se ne takimin e pare ne Veternik te pompa e derivateve "Shell", i akuzuari Kushtrim i ka ofruar një skenar se si me automjet duhet te inskenohet një aksident, ku, me veture duhet qe ta kryej aksidentin por, gjer te ky inskenim nuk ka ardhur pasi qe Graniti ka refuzuar ta kryej këtë veprim. Ne takimin e dyte tek pompa e derivateve te "Benita" i akuzuari Granit pohon takimin si dhe jep ca detaje lidhur me premtimet dhe te hollat qe kanë pranuar nga Naimi, si dhe shton se pak para se te largohemi jemi marre vesh qe te kryhet kjo pune. Po ashtu, ky, i akuzuar ne këtë intervistim pohon se çdo here ne takim me Naimin, jam takuar përmes Kushtrimit. Ne shqyrtimin gjyqësorë i akuzuari Granit, po, për te njëjtin rast jep një verzion tjetër lidhur me veprimet e te akuzuarit Kushtrim, i cili pohon se Kushtrimi, nuk ka te beje asgjë me këtë vepër penale. Po ashtu, shton se disa dite para vrasjes ka pasur kontakte te vazhdueshme me Naimin, por, pa prezencën e te akuzuarit Kushtrim. Si aktakuza por edhe aktgjykimi lidhur me te akuzuarin Kushtrim rezulton se është ndërtuar mbi bazën e deponimit te akuzuarit Granit, megjithatë ne asnjë version te mbrojtjes se tij ky i akuzuar nuk potencon ndonjë veprim konkret qe ka te beje me ndihmën, duke filluar nga këshillat, udhëzimet, gjetjen e mjetit - armës, sigurimin e automjeteve, lëvizjes se tyre te përbashkëta, e sidomos, ditën kritike deri ne momentin e vrasjes. Kjo mbrojtje e tij ne të gjitha procedurat ne këtë çështje është kundërthënëse me njëra - tjetrën, ne versionin e pare, nuk e përfshin fare te akuzuarin Kushtrim, jo vetëm me ndonjë veprim qe e ka ndihmuar çka e mohon se njihet përmes Kushtrimit me Naimin. Ne versionin e dyte pohon te kundërtën cak pohon se pos takimeve qe ju ka mundësuar Kushtrimi me Naimin potencon edhe një skenar për vrasje qe i ka ofruar Kushtrimi me ane te një aksidenti ne komunikacion për vrasje te cilën ofertë kinse e ka refuzuar. Gjate shqyrtimit gjyqësorë, e përjashton ne tersi pjesëmarrjen e te pandehurit Kushtrim ne këtë çështje penale duke shtuar se Kushtrimi nuk ka te beje asgjë me këtë vrasje dhe se Kushtrimi as qe ka ditur për takimet dhe kontaktet qe ka pasur me Naimin bile shkon edhe me tej duke shtuar se Naimi i ka thënë qe mos te din asgjë Kushtrimi për veprimet e tyre. Këto versione te mbrojtjes se tij, ashtu siç qëndrojnë, nuk ka nevoje as te ballafaqohet me prova te tjera ne

mënyrë qe t'i epët epiteti i një prove te besueshme sepse e përjashtojnë ne tersi njëra tjetrën. Jo vetëm se janë kundërthënëse dhe te pabesueshme por këtë mbrojtje nuk e mbështet asnjë prove tjetër formale dhe materiale qe janë administruar. Po ashtu, edhe i akuzuari Naim pohon se nuk e ka njohur te akuzuarin Granit, por, për here te pare me te njëjtin ka qëndruar ne prezence te akuzuarit Kushtrim, ky i akuzuar ne mbrojtjen e tije nuk vërteton asnjë pretendim te akuzuarit Granit. Ligjdhënësi ndihmën e përcakton si forme te bashkëpunimit për kryerjen e një vepre penale ku parasheh disa veprime nga ana e ndihmësit e te cilat veprime hyjnë ne zonën kriminale dhe ndëshkohen e siç janë: dhënia e këshillave dhe udhëzimeve se si te kryhet vepra penale, venja ne dispozicion e mjeteve për kryerjen e veprave penale, krijimin e kushteve apo menjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale, premtimin për paraprak se do te fsheh provat e kryerjes se veprës penale, fshehjen e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale apo përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale (shif dispozitat nga komentari i KPRK-se nen33 par.2). Ne rastin konkret askund për asnjë moment jo vetëm natën kritike por as disa ditë para natës kritike i akuzuari Kushtrim, nuk është parë dhe takuar me asnjërin te akuzuar, nuk ka takuar as persona te tretë qe munde t'i përcjellin ndonjë këshillë apo udhëzim se si te kryhet ajo vepër penale. As një dëshmitar i proceduar, nuk e vërteton asnjë veprim inkriminues te akuzuarit Kushtrim ne kryerjen e kësaj vepre penale edhe ata dëshmitarë, qe e njohin apo kanë dëgjuar pohojnë fakte krejtësisht te tjera qe nuk kanë te bëjnë me vepër penale, ata ose janë bashkëfshatar me te akuzuarin Kushtrim apo ne ndonjë lidhje tjetër farefisnore, por, asnjeri nga këta jo vetëm ditën kritike por me dite dhe muaj para ditës kritike nuk e kanë parë dhe takuar si dhe nuk kanë dëgjuar për asnjë veprim inkriminues, përjashto palën e dëmtuar dëshmitarin Leonard, i cili është edhe me tepër subjektiv kur i referohet veprimeve te akuzuarit Kushtrim, pra, ne një mënyrë mundohet qe Kushtrimin ta paraqet si hallke shume te rëndësishme në këtë çështje penalo - juridike. Prandaj, kjarte shihet se ky dëshmitar është subjektive jo vetëm për faktin se është i interesuar për rrjedhe te procedurës por dëshminë e tij nuk e mbështet në asnjë prove formale e as materiale, thjeshte dëshmia e tije është shume paragjykuese dhe jo serioze edhe pse gjykata siç shihet nuk i ka dhënë ndonjë rendësi provuese sa i përket te akuzuarit Kushtrim. Pra, as një prove materiale, e që janë CD-et e ditës kritike si dhe komunikimet e telefonave mese te akuzuarve edhe para ditës kritike nuk e involvojnë te akuzuarin Kushtrim, ne kryerjen e kësaj vepre penale, ku qarte shihet se te akuzuarit Granit dhe Naim, kanë pasur komunikime mes vete nga dt. 24 - 29 vazhdimisht deri pak para ndodhjes se vrasjes, prandaj, si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, propozon që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesën e mbrojtësve të akuzuarve Naim Museli, av. Shemsedin Pira dhe av. Teuta Zhinipotoku, të akuzuarit Granit Plava, av. Skender Gojani dhe të akuzuarit Kushtrim Kokalla, av. Ndrecë Dodaj, ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. Leotrim Syla, me arsyetim se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor pa dyshim që është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale dhe atë; për të akuzuarin Naim Murseli, vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin Granit Plava për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1, pika 1.6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, dhe për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1, pika 1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, prandaj, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, për çka, më tutje, në arsyetimin e përgjigjes në ankesë, vazhdohet me konstatimin se pretendimet ankimore të ngritura në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve

janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme në raport me aktgjykimin e gjykatës, ngase, arsyetimi i aktgjykimit, pra, edhe dispozitivi i tij është i qartë dhe konkret dhe nuk përmban kundërthënie në vete - veten e as në arsyetimin, e që një gjë të tillë, rezulton nga provat personale dhe materiale të paraqitura në aktgjykimin në fjalë, ku, më tutje, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar fillon me paraqitjen e detajuar të përmbajtjes së deklaratave të dëshmitarëve, të dëmtuarit por edhe provave materiale, e duke konstatuar se gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë kur, të akuzuarit i ka shpallur fajtorë, për çka, edhe propozon vërtetimin e aktgjykimit të ankimuar. përkitazi me dy të akuzuarit të parë, kurse, për të akuzuarin e tretë të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në kuptim të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar përkitazi me vendimin për dënim. Më tutje, në përgjigje të ankesës vazhdohet me konstatimin se i akuzuari Granit Plava, nuk është shpallur fajtor vetëm pse arma është gjetur në shtëpinë e tij, por, për arsye se kjo provë materiale lidhet në mënyrë të drejtë për drejtë, sipas ekzaminimit balistik me privimin nga jeta të tani të ndjerës, ku, vërtetohet se predha e shkrepur në trupin e tani të ndjerës është shkrepur pikërisht nga arma në fjalë, pastaj, lëvizjet e veturave të akuzuarve, por, edhe përmes lokalizimit të telefonave në kohën e kryerjes së veprës penale, por, edhe deklaratat e vetë të akuzuarve vërtetohet se i akuzuari Granit Plava, ishte personi që ka shtënë në drejtim të tani të ndjerës. Kjo, pastaj, vërtetohet se arma në fjalë është blerë bashkërisht nga të akuzuarit Granit Plava dhe Naim Murseli, ku, arma në fjalë është provuar nga dy të akuzuarit e më pas, është marr në posedim nga i akuzuari Granit, e cila armë, më pastaj, është fshehur nga i akuzuari Granit Plava në oborrin e tij dhe është gjetur gjatë bastisjes së shtëpisë së tij, së bashku me nëntëmbëdhjetë fishekë tjerë, prandaj, pretendimi i mbrojtjes se dikush tjetër mund ta ketë mbajtur armën në atë sekond, është vetëm një supozim teorik e pa mbështetje në prova dhe shkresa tjera të lëndës, pra, mbrojtja nuk ka ofruar asnjë provë se arma i është dhënë ndonjë personi të tretë në momentin e kryerjes së veprës penale. Kurse, në anën tjetër gjykata e shkallës së parë, ka ardhur në përfundim se dhe atë, duke u mbështetur në prova materiale dhe personale sa i përket dinamikës së ngjarjes, lëndime të viktimës dhe pozicionit të personave dhe ka bërë ndërlidhjen e ekspertizës mjeko-ligjore, edhe me provat tjera materiale dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, që do të thotë se asnjë fakt vendimtar nuk ka mbetur në nivelin e dyshimit por, të gjitha provat kanë vërtetuar në mënyrë të padyshimtë fajësinë e të akuzuarit. Mbrojtja në ankesë, po ashtu, pretendon se gjykata e shkallës së parë, nuk ka arritur të jap përgjigje të plotë përkitazi me identifikimin e të akuzuarit Granit Plava, si personi që ka shtënë me armë zjarri - duke pretenduar kështu se nuk ka dëshmitarë okular e duke mos përjashtuar mundësinë e përdorimit të armës nga personi tjetër, pretendim ky, që nuk qëndron, ngase, gjykata e shkallës së parë, me provat që ka proceduar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pa dyshim që ka vërtetuar se i akuzuari Granit Plava, ishte personi që ka shtënë me armë zjarri ditën kritike, që do të thotë se edhe për këtë të akuzuar ka vërtetuar në gjendjen faktike të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke propozuar kështu, që aktgjykimi i ankimuar edhe përkitazi me këtë të akuzuar të vërtetohet, ndërsa, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.



Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara, ngase, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par. 10, par. 2 nën par. 4 dhe 5 e lidhur me dispozitat e nenit 369 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin, ku, janë paraqitur të gjitha arsyerat në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla si dhe përkitazi me zbatimin të caktuar të dispozitave të kodit penal ndaj të akuzuarve dhe veprës penale të tyre, pastaj, i njëjti nuk ka mbështetje në prova të pranueshme e po ashtu, është vendosur në tërësi për objektin e aktakuzës dhe gjithashtu, edhe përpilimi i dispozitivit është bërë konform dispozitave të nenit 369 par. 4 e lidhur me nenin 364 të KPPRK-së, ku, janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat përkitazi me ngjarjen kritike, fakte dhe rrethana këto nga të cilat plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprave penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe nën par. 4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të akuzuarin Naim Murseli, gjegjësisht, vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par.1 nën par. 6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, për të akuzuarin Granit Plava dhe ndihmë në kryerjen e veprës penale nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe nën par. 4 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, për të cilat vepra penale, pra, edhe janë shpallur fajtorë të akuzuarit në fjalë. Në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë, po ashtu, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kur, për dy të akuzuarit e parë, pra, për të akuzuarin Naim Murseli dhe të akuzuarin Granit Plava, ka përpiluar dy dispozitiva për dy të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, pra, për secilin veç e veç, edhe pse bëhet fjalë për një vepër penale të vrasjes së rëndë, në bashkëkryerje, kjo, për arsye se tek i akuzuari Naim Murseli, forma kualifikuese e veprës penale - pra, vrasjes së rëndë, ndryshon nga forma kualifikuese e veprës penale të vrasjes së rëndë tek i akuzuari Granit Plava, prandaj, edhe pse, bëhet fjalë për një vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka përpiluar dy dispozitiva, ku, i akuzuari Naim Murseli, është shpallur fajtor për vepër penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe nën par. 4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa, i akuzuari Granit Plava për vepër penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par.1 nën par. 6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase, tek i akuzuari Naim Murseli bëhet fjalë për formën tjetër kualifikuese - pra, aferësinë familjare, si element kualifikues i veprës penale, ngase, ky i akuzuar ka kryer veprën penale të vrasjes ndaj bashkëshortes së tij, e po ashtu, gjatë kryerjes së veprës penale ka vepruar edhe në mënyrë dinake, formë kjo pra, tjetër e kualifikuar e veprës penale të vrasjes, kurse, tek i akuzuari Granit Plava, kur, është fjala për formën kualifikuese të veprës penale, si formë cilësuese është marr përfitimi i dobisë pasurore, prandaj, gjykata e shkallës së parë, edhe e ka ndarë veprën penale në dy dispozitiva, pra, për secilin të akuzuar veç e veç, pra, duke e shpallë fajtor të akuzuarin Naim Murseli për veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe nën par. 4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse, të akuzuarin Granit Plava, për vepër penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par.1 nën par. 6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prandaj, fakti se bëhet fjalë për bashkëkryerje nuk ka qenë pengesë që të akuzuarit të shpallen fajtorë me dispozitiva të veçantë, edhe pse, pra, bëhet fjalë për një vepër penale të kryer në bashkëkryerje të kryer nga dy të akuzuarit, e jo dy vepra penale sikur që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve, prandaj, me këtë nuk mund të flitet për mos vendosjen e objektit të akuzës në tërësi, sikur, që pretendojnë mbrojtësit e të

akuzuarit Naim Murseli, av. Shemsedin Pira dhe Teuta zhinipotoku. Kur, jemi tek dispozitivi menjëherë duhet potencuar se nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit Naim Murseli, av. Shemsedin Pira dhe av. Teuta Zhinipotoku, se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vendosur për tërë objektin e akuzës, ngase, kur, është fjala për të akuzuarin Naim Murseli, nuk bëhet fjalë për dy veprat penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje, por, bëhet fjalë për një vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje, mirëpo, gjatë përshkrimit të veprave penale tek i akuzuari Granit Plava, gjykata e shkallës së parë, ka përshkruar edhe veprimet inkriminuese të akuzuarit Naim Murseli, e që veprimet e njëjta inkriminuese janë përshkruar edhe tek vepra penale e vrasjes së rëndë, që i vihet në barrë të akuzuarit Naim Murseli, e që kjo ka ndodhur për shkak të ndarjes së dispozitivave për dy të akuzuarit, por, jo se bëhet fjalë për dy vepra penale për të akuzuarin Naim Murseli, sikur që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarit, e që arsyet më në detaje u cekën edhe më lartë, prandaj, në këtë drejtim nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur, nuk ka vendosur për dy vepra penale të vrasjes së rëndë për të akuzuarin Naim Murseli. Për rikujtim është e nevojshme këtu, të potencohet edhe sikur të qëndronte pretendimi ankimor i mbrojtësve të akuzuarit Naim Murseli, atëherë, shkelja në fjalë do të konsiderohej shkelje e ligjit penal në favor të akuzuarit, që, edhe ashtu, s'do të merrej parasysh, ku, nga ana e prokurorisë nuk ka ankesë në këtë drejtim, prandaj, edhe në këtë drejtim pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit Naim Murseli, janë të pabazuara dhe juridikisht të paqëndrueshme. Po ashtu, kur, bëhet fjalë për dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, i njëjti - pra, dispozitivi është përpiluar konform dispozitave të nenit 364 të KPPRK-së, dispozitë kjo, me të cilën kërkohet shprehimisht se në aktgjykimin në të cilin i akuzuari shpallet fajtor, shënohet vepra penale për të cilën i akuzuari shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave të Kodit Penal, si dhe emërtimi ligjor i veprës penale, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, gjë që, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, përveç, që janë përshkruar të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarve, pra, duke përfshirë tre të akuzuarit në tre dispozitiva, përkitazi me mënyrën se si janë kryer veprat penale në fjalë, po ashtu, janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese që përbëjnë formën cilësuese të veprave penale të vrasjes, për secilin veç e veç, pra, bëhet fjalë për vrasje të rëndë të kryer ndaj anëtarit të familjes, pra, bashkëshortes së të akuzuarit Naim Murseli, pra, kuptohet kur, është fjala për të akuzuarin Naim Murseli, është përshkruar forma kualifikuese për të akuzuarin në fjalë, pastaj, janë përshkruar veprimet inkriminuese që përbëjnë elementet cilësuese të dinakërisë, kuptohet, kur, është fjala për të akuzuarin Naim Murseli, e po ashtu, edhe për të akuzuarin Granit Plava janë përshkruar veprimet inkriminuese që përbëjnë formën e kualifikuar të veprës penale pra, të vrasjes së rëndë e që ka të bëjë me përfitimin e dobisë pasurore tek ky i akuzuar, pra, për të akuzuarin Granit Plava, pra, edhe për njërin edhe për tjetrin, gjykata e shkallës së parë, ka përshkruar të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë elementet e veprës penale për të cilët këta dy të akuzuar janë shpallur fajtorë, gjë që, të njëjtën gjë e ka bërë edhe për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, kur, është fjala për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga dy të akuzuarit e parë, prandaj, edhe dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është ndërtuar konform dispozitave të nenit 364 të KPPRK-së, duke përfshirë pra, këtu edhe veprën penale të armë mbajtjes për të akuzuarin Granit Plava, mirëpo, pasi që mbrojtësi i të akuzuarit nuk e ka kontestuar në këtë drejtim edhe kjo gjykatë nuk bëri elaborim më të gjerë për këtë vepër penale. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kur, për të akuzuarin Granit Plava, ka shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm, për dy vepra penale, pra, për veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173, par. 1 pika

1.6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, kuptohet pa e bërë më parë shqiptimin e dënimit për secilën vepër penale veç e veç, e pastaj, të shqiptojë dënim unik, ngase, sipas dispozitave të nenit 70 par. 1 dhe par. 2 nën par. 1 të KPRK-së, konstatohet se nëse, për ndonjërën prej veprave penale në bashkim, gjykata shqipton dënim me burgim të përjetshëm, atëherë, e njëjta shqipton vetëm një dënim dhe atë, dënim me burgim të përjetshëm, prandaj, në rastin konkret pasi që gjykata e shkallës së parë, ka shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm për të akuzuarin Granit Plava, për veprën e parë penale, me zbatimin e dispozitave të parapara për veprat penale të kryera në bashkim, ka shqiptuar vetëm një dënim, pra, dënim me burgim të përjetshëm. Po ashtu, në dispozitivi, sa i përket veprës penale të vrasjes së rëndë, janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese të akuzuarve të ndërmarra në momentin kritik të kryerjes së veprave penale, por, edhe veprimet tjera të akuzuarve, përkitazi me motivin e kryerjes së veprës penale, por, edhe faktet dhe rrethanat që edhe i kanë paraprirë kryerjes së veprës penale, e që në bazë të veprimeve në fjalë, rezulton se bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së rëndë të kryer me dashje direkte nga të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, ndërsa, për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, ndihmë në kryerjen e veprës penale, e jo sikur që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve se nuk janë kryer veprat penale nga të akuzuarit dhe se për faktin edhe pse kanë biseduar të akuzuarit më parë, për kryerjen e veprës penale në bashkëkryerje ditën kritike, megjithatë, i akuzuari Granit Plava nuk ka shtënë ditën kritike në tani të ndjerën, por, këtë e ka bërë personi i maskuar identiteti i të cilit ishte i panjohur, e duke aluduar kështu se, nuk kanë njohuri për identitetin e tij, që do të thotë se edhe në këtë drejtim, përveç, që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar edhe arsyetimi përfshin të gjitha veprimet inkriminuese që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pra, për të akuzuarin Naim Murseli, vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, për të akuzuarin Granit Plava si dhe ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për të akuzuarin Kushtrim Kokalla. Prandaj, për faktet dhe rrethanat në fjalë edhe në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyerat e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penalo - juridike, duke vepruar kështu, pra, konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPPRK-së, dhe se gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kur, në arsyetimin e sajë në faqen 9, pasusi 3, konstaton; "se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i akuzuari Naim Murseli, për shkak të raporteve të çrregulluara familjare dhe martesore, gjatë të cilave kanë lindur mllefi dhe dëshira për hakmarrje, i njëjti ka bërë planin ta largoj Liridonen nga jeta e tij, andaj, pas datës 25.06.2022, kur është paguar polisa e sigurimit jetësor në emër të Liridona Ademajt, me kompaninë "Folksam" në shumë prej 3.000.000. kruna Suedeze, me qëllim që pas vrasjes të këtë edhe dobi financiare, i akuzuari Naim, të akuzuarit të tretë Kushtrim Kokallës, ia ka shpalsur planin e likuidimit të bashkëshortes së tij dhe nga ai, ka kërkuar të gjej mundësi për vrasjen e saj, pas çka i akuzuari Kushtrim Kokalla, fillimisht ka refuzuar, e më pas ka gjetur të pandehurin e dytë Granit Plavën, me të cilin e ka njoftuar të akuzuarin Naim Murselin dhe të tretë janë dakorduar që i akuzuari Granit, ta kryej vrasjen me marrëveshje që i akuzuari Naim, t'ia paguaj kompensimin në shumë prej 30.000 €, ndërsa i akuzuari Naim, me datë 29.11.2023 ka siguruar armën e zjarrit pistoletën e markës "Zastava" ngjyrë e zezë, me numër serik ET-991503 dhe 20 fishek të kalibrit 6mm të cilat i ka blerë rreth orës 14:00, po të njëjtën ditë nga i pandehuri i katërt Tom Dodaj, në shumë prej 280 euro, të cilën armë ia ka dhënë të pandehurit të dytë Granit Plavës, i cili armën e përmendur e ka përdorur për vrasjen e tani të ndjerës.

Liridona Ademaj, që e ka kryer të njëjtën ditë, në orët e mbrëmjes, në intervalin kohor prej orës 20:11 deri në ora 20:18, në vendin për të cilin është dakorduar me të akuzuarin Naim, të cilin e kanë inskenuar që të duket si grabitje ndërsa i akuzuari Naim, në mënyrë dinake, me dorën e tij të djathtë, ka mbajtur Liridonën në krahun e dorës së saj të majtë, me qëllim që ajo mos t'i shmanget plumbit, pas çka i akuzuari Naim, me fëmijët ka dal nga vetura dhe është larguar nga vendi i ngjarjes", pastaj, në vazhdim, përkitazi me të akuzuarin Granit Plava, vazhdohet me konstatimin se: "është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se, i akuzuari Granit Plava, me datë 29.11.2023 në intervalin kohor prej orës 20:11 deri 20:18, në fshatin Bërnicë, në rrugën "Dalip Alshiqi" lagjja "Chelsea Point" Komuna e Prishtinës, pas marrëveshjes paraprake, me të akuzuarin e parë Naim Murseli, ashtu që, pasi, i akuzuari i parë Naim Murseli, me veturën e markës "BMË" me targat e Suedisë MJB -556, në të cilën ende kanë qenë tani e ndjera Liridona Ademaj dhe fëmijët e tyre të moshës 4 dhe 6 vjeç, Diar dhe Dion Murseli, i ka dhënë shenjë me dritat të veturës të akuzuarit të dytë Granit Plavës, ai befas ka dal përpara veturës me maskë në kokë dhe pistoletë në duar, derisa i akuzuari i parë Naim Murseli, ka ndaluar dhe ka fikur motorin e veturës dhe me dorën e tij ka mbajtur Liridonen, për krahun e dorës së saj të majtë, i akuzuari i dytë Granit Plava, për kompensim në shumë prej 30.000 €, nga afërsia e drejtë për drejtë përmes dritares gjysmë të hapur nga ana e pasagjerit, ka shtënë një fishek nga pistoleta në drejtim të Liridonës dhe e qëllon në kokë, në pjesën mbrapa veshit të djathtë, duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse si pasojë e të cilave e njëjta, ka ndërruar jetë në vendin e ngjarjes, vdekja e së cilës, në bazë të raportit të autopsisë së kryer MA 23-414 të dt. 10.01.2024, të ekspertit të lëmisë mjeko ligjore, është kualifikuar, "vdekja e të ndjerës Liridona Ademaj, ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme trunore, si pasojë e plagës tejshkuese në regjionin e kokës - trurit, nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit në regjionin e kokës", pastaj, për veprën penale të armëmbajtjes, po ashtu, konstatohet se: "është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Granit Plava, nga data 29.11.2023 rreth orës 14:00 deri me datën 01.12.2023 rreth orës 16:15, ku është kryer bastisja në shtëpinë e tij në fshatin Cërmnjan, Komuna e Gjakovës, ku është gjetur arma, pa autorizim dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për armë, ka mbajtur një armë zjarri - pistoletën e markës "ZASTAVA", ngjyrë e zezë, me numër serik ET-991503, së bashku me 19 fishek të kalibrit 6mm, me të cilën e ka kryer veprën penale nga paragrafi 2 i dispozitivit të kësaj aktakuze e të cilën i akuzuari Naim, me datë 29.11.2023 e ka blerë rreth orës 14:00 nga i pandehuri i katërt Tom Dodaj për shumën prej 280 €," si dhe në fund për të akuzuarin Kushtrimn Kokalla, kur, konstaton se: "është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari Kushtrim Kokalla, pasi që i pandehuri Naim Murseli, ka kërkuar nga i akuzuari Kushtrim Kokalla, që të gjej mundësi për vrasjen e Liridona Ademajt dhe i njëjti ka refuzuar, i akuzuari Kushtrim, ka gjetur të pandehurin e dytë Granit Plava, me të cilin e ka njoftuar të akuzuarin Naim Murselin dhe të tretë janë dakorduar që i akuzuari Granit, ta kryej vrasjen, me marrëveshje që i akuzuari Naim, t'i paguaj kompensim në shume prej 30.000 €, për çka i akuzuari Naim, me datë 29.11.2023, ka siguruar armën e zjarrit - pistoletën e markës "Zastava" ngjyrë e zezë, me numër serik ET-991503 dhe 20 fishek të kalibrit 6mm, të cilat i ka blerë rreth orës 14:00, po të njëjtën ditë nga i pandehuri i katërt Tom Dodaj, në shumë prej 280 €, të cilat ia ka dhënë të pandehurit të dytë Granit Plavës, i cili armën e përmendur e ka përdorur për vrasjen e tani të ndjerës Liridona Ademaj", për arsye se gjykata e shkallës së parë, gjatë arsyetimit të sajë të mëtutjeshëm, megjithatë, konstaton se fakte dhe rrethanat në fjalë janë vërtetuar, që do të thotë se nuk flitet për dyshim të bazuar mirë, sikur që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve, por, flitet për fakte dhe rrethana të vërtetuara edhe pse në kontest të kësaj gjykata e shkallës së parë, nuk ka pasur nevojë të përdor fjalët "përtejë dyshimit të bazuar mirë", kur, në një pjesë tjetër të arsyetimit të sajë - arsyetimit të aktgjykimit të ankimuar potencon se bëhet fjalë për fakte dhe rrethana të vërtetuara, sidomos, kur, në faqen 70 pasusi 2 të arsyetimit, konstaton për të gjithë të akuzuarit se është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale, dhe atë; i

akuzuari Naim Murseli veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari Granit Plava, veprën penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, si dhe i akuzuari Kushtrim Kokalla, veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, ku, më pastaj, ka vazhduar në faqen e njëjtë, pra, 70-të, pasusi 3 të arsyetimit të aktgjykimit të ankimuar, sqaron edhe dashjen e të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në fjalë, tani pra, gjykata e shkallës së parë, nuk lejon mëdyshje në vërtetimin e fakteve dhe rrethanave që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilat të akuzuarit edhe janë shpallur fajtorë, prandaj, nuk mund të flitet për dyshim të bazuar mirë, sikurse, që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve, por, është fjala për fakte dhe rrethana të vërtetuara, e që, gjykata e shkallës së parë, gjatë arsyetimit të sajë, në disa raste, si në rastin konkret ka konstatuar fjalët "përtej dyshimit të bazuar mirë", mirëpo, duke pasur parasysh pjesën tjetër të arsyetimit të aktgjykimit të ankimuar, ku, konstatohet se a janë vërtetuar faktet dhe rrethanat në fjalë, e që, është fjala për faktet dhe rrethanat të njëjta, ku, është konstatuar "përtej dyshimit të bazuar mirë", atëherë, pa mëdyshje që një konstatim i tillë nuk e bënë arsyetimin të pa qartë dhe juridikisht të papranueshëm.

Prandaj, për faktet dhe rrethanat në fjalë, edhe në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe atë, për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë, sidomos, kur, në dispozitiv ka përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë mbështetje, përveç, në provat materiale në shkresat e lëndës, pjesërisht, edhe vetë deklaratat e të akuzuarve, e sidomos, kur, të njëjtat krahasohen edhe me provat materiale në shkresa të lëndës si, raporti për bastisjen e datës 01.12.2023, e kryer tek të dyshuarit, Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, vërtetimi për konfiskimin e përkohshëm të mjeteve i datës 01.12.2023 nga Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, raporti informues i datës 27.12.2023, ku, në mes tjerash, thuhet "nga data kur ka ndodhur rasti, me 29.11.2023, nga vendi i ngjarjes ku ka ndodhur vrasja", raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. AKF/2023-3930/23-3827, i datës 27.02.2024, për kryerjen e analizës së ADN-së, me të cilin është kryer krahasimi me profilet e ADN-së në bazën e të dhënave i datës 24.03.2024, raporti i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nr. AKF/2023-3913/23-3798, i datës 14.12.2023, për ekspertizën balistike të pistoletës së markës "ZASTAVA", ngjyrë e zezë, me numër serik ET-991503 dhe një gëzhojë e kalibrit 6.35 x 15mm (pjesa përbërëse e raportit të datës 27.12.2023, raporti mbi Autopsinë e kryer MA23-414, i datës 10.01.2024, e ekspertit të lëmisë mjeko-ligjore Dr. Naim Uka, për ekspertizën e kufomës së të ndjerës Liridonë Murseli, raporti preliminar i analizës së provave (telefonave) i datës 14.01.2024 për ekspertimin e telefonave të pandehurve me raport të datës 28.02.2024, raporti përfundimtar analitik i video - incizimeve i datës 21.01.2024, për analizën e video-incizimeve që janë grumbulluar nga vendet e ndryshme (pompa e derivateve "Kastrati", Etno Kuca - Graçanicë, Titanium, Shpresim Pestisha, Shkelzen Uka, Suad Peshtisha, Fehmi Mehmeti, Trafiku Urban, Berisha dyer), raporti informativ i datës 24.03.2024, për transaksionet bankare të kryera nga bankat e ndryshme (Banka Ekonomike, BKT, Mabetex Holding, Chelsea Point) të akuzuarit Naim Murseli dhe të gjithë informatave relevante për obligimet financiare, përgjigjja e organeve kompetente të Mbretërisë së Suedisë JuBC2024/00208, e datës 08.05.2024, dy (2) CD për raportin e Ipko-s në telefonat e të pandehurve Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, një (1) DVD nga kamera e restorantit "Etno House" në Graçanicë, një (1) DVD për lëvizjen e veturave të pandehurve Naim Murseli dhe Granit Plava nga kamerat e vendeve të ndryshme, një (1) DVD me video dhe audio-incizim, në të cilin

shumë qartë është ndarë audio - incizimi dhe kërcitja (e shtëna), ndihet edhe e shtëna, pra është vetëm dëgjimi i asaj të shtëne e cila përputhet me atë që gjatë vrasjes së Liridones është shkrepur një plumb dhe është gjetur gëzhoja e atij plumbi, pastaj, ekspertiza e psikiatrisë për të akuzuarit, për dy të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, përkitazi me gjendjen e tyre mendore në momentin e kryerjes së veprës penale, por, edhe aftësinë e tyre për pjesëmarrje në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e më pastaj, është bazuar edhe në deklaratat e dëshmitarëve si, dëshmitarit - të dëmtuarit Leonard Ademaj, dëshmitarëve Jeton Binaku, Hasan Hasanaj, Naim Sadiku, Florian Avdija, Aurel Pajaziti dhe Kanun Kokalla, pastaj, deklaratat e ekspertëve të psikiatrisë, Dr. Shpend Haxhibeqiri dhe Dr. Bujar Obërtinca si dhe atij të mjekësisë ligjore Dr. Naim Uka, ku, nga dëshmitarët në fjalë, janë vërtetuar në detaje raportet në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës Liridona Ademaj, duke përshkruar në detaje se si i akuzuari Naim Murseli dhe tani e ndjera Liridona Ademaj, kanë pasur raporte jo të mira, kuptohet herë pas here edhe zënka familjare dhe se sipas dëshmitarëve në fjalë kryesisht kanë pasur mospajtime rreth raporteve të tyre personale, pra, edhe njëri edhe tjetri, kanë dyshuar për sjelljet e tyre në raportet bashkëshortore, e që, tani i akuzuari Naim Murseli, ka vendosur që tani të ndjerën ta largojë nga jeta e tij, pastaj, pjesërisht nga vetë deklaratat e të akuzuarve, ku, përkitazi me këtë i akuzuari Naim Murseli, ka biseduar së pari me të akuzuarin Kushtrim Kokalla, duke i ofruar që ky ta privojë nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, kuptohet, duke i ofruar para për një gjë të tillë, mirëpo, i akuzuari Kushtrim Kokalla ka refuzuar një gjë të tillë, por, i ka ofruar që këtë ta bëjë i akuzuari Granit Plava, ku, i akuzuari Kushtrim Kokalla e njofton të akuzuarin Naim Murseli me të akuzuarin Granit Plava dhe më pastaj, këta dy të fundit vendosin që ta bëjnë planin për ta privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, e që, gjatë bisedave të tyre, ka marr pjesë edhe i akuzuari Kushtrim Kokalla, biseda këto, që janë vërtetuar, përveç, pjesërisht nga vetë deklaratat e të akuzuarve edhe nga provat materiale në shkresa të lëndës, e sidomos, video incizimet përkitazi me lëvizjen e dy të akuzuarve të parë, me automjetet e tyre, pra, të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, e pastaj, edhe nga kontaktet në telefonat e tyre, por, që më në detaje janë vërtetuar edhe nga ekspertiza mjeko-ligjore, raporti i autopsisë së tani të ndjerës Liridona Ademaj, pastaj, ekspertiza e balistikës, ku, vërtetohet se arma që është gjetur tek i akuzuari Granit Plava, ka qenë arma që është përdorur ditën kritike dhe është privuar nga jeta tani e ndjera Liridona Ademaj, e që është vërtetuar përmes përputhshmërisë së armës në fjalë me predhën e gjetur në vendin e ngjarjes, predhë kjo, me të cilën edhe është qëlluar me armë zjarri tani e ndjera Liridona Ademaj, e që si pasojë e plagëve në fjalë, tani e ndjera Liridona Ademaj, ka mbetur e vdekur në vendin e ngjarjes, që do të thotë se me këtë edhe ka ardhur deri tek privimi nga jeta i tani të ndjerës Liridona Ademaj, e që pa mëdyshje është vërtetuar se ditën kritike i akuzuari Granit Plava, ka ndërmarrë veprime konkrete inkriminuese në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjë që, këtë e ka bërë së bashku me të akuzuarin Naim Murseli, i cili në momentin kritik ishte në vendin e ngjarjes, pra, së bashku me tani të ndjerën Liridona Ademaj, në një automjet, ku, para se i akuzuari Granit të qëllojë me armën e tij të zjarrit, i akuzuari Naim Murseli, përveç, që e ka sjellë tani të ndjerën në vendin e ngjarjes, sipas marrëveshjes me të akuzuarin Granit Plava, po ashtu, në momentin kritik të njëjtën - pra, tani të ndjerën Liridona Ademaj, e ka mbajtur për krahu duke ia mundësuar të akuzuarit Granit Plava, që ta qëllojë me armë zjarri tani të ndjerën, ku, i njëjti vetëm me një të shtënë arrin ta privojë nga jeta tani të ndjerën, faktet këto dhe rrethana që i vërteton i dëmtuari Leonard Ademaj, por, që kanë mbështetje edhe në ekspertizën mjeko - ligjore, si dhe deklaratën e ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. Naim Uka, ku, vërtetohet se tek tani e ndjera janë shkaktuar lëndime - ndrydhje në krahun e tani të ndjerës, e që përputhen me deklaratën e dëshmitarit - të dëmtuarit Leonard Ademaj, i cili faktet dhe rrethanat në fjalë i ka deklaruar në bazë të asaj që ka dëgjuar nga fëmiu i tani të ndjerës, që ishte prezent në vendin e ngjarjes dhe atë, në momentin, kur, i akuzuari Granit Plava ka shtënë në drejtim

të tani të ndjerës, kuptohet, sipas marrëveshjes me të akuzuarin Naim Murseli, pra, nga vetë deklarata e të akuzuarve Naim Murseli dhe Granit Plava, nuk kontestohe faktet dhe rrethanat se në vendin e ngjarjes ishin edhe njëri edhe tjetri, pra, kur, është privuar nga jeta tani e ndjera Liridona Ademaj, se më parë, kanë biseduar për vrasjen e tani të ndjerës Liridona Ademaj, fakte këto dhe rrethana që vërtetohen nga i akuzuari Granit Plava. Ndërsa, për atë, se kush qëllojë me armë zjarri në drejtim të tani të ndjerës, gjykata e shkallës së parë, ka marr parasysh vetë mënyrën e shpjegimit të ngjarjes, se ku ishin të akuzuarit Granit Plava dhe Naim Murseli, në momentin kritik, e duke pasur parasysh vendin-pjesën e trupit, ku, është qëlluar me armë zjarri tani e ndjera, e me këtë, edhe ndrydhjet e shkaktuara nga i akuzuari Naim Murseli, tek tani e ndjera në krahun e sajë, atëherë, pa mëdyshje që vërtetohet se me armë zjarri ka shtënë i akuzuari Granit Plava, kurse, i akuzuari Naim Murseli, përveç, që e ka sjellë tani të ndjerën në vendin e ngjarjes, po ashtu, i njëjti edhe e ka mbajtur tani të ndjerën për krahu derisa, i akuzuari Granit Plava, ka shtënë me armën e tij të zjarrit, e në kontest të kësaj, gjykata e shkallës së parë, ka marr parasysh edhe deklaratën e të akuzuarit Granit Plava, i cili e ka pranuar se i akuzuari Naim Murseli, i ka ofruar edhe para, si shpërblim që ky i fundit ta privojë nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, prandaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë, nuk ka aprovuar pretendimin e të akuzuarit Granit Plava, se me armë zjarri ka shtënë i akuzuari Naim Murseli, apo edhe personi i tretë i pa identifikuar, sikur që pretendon i akuzuari Naim Murseli, mirëpo, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar as që mund të flitet për prezencën e personit tjetër në vendin e ngjarjes, përveç, dy të akuzuarve - pra, të akuzuarit Granit Plava dhe të akuzuarit Naim Murseli, e që, ky i fundit, është vërtetuar se ishte së bashku me tani të ndjerën Liridona Ademaj dhe dy fëmijët e tyre në automjet në momentin kur, me armë zjarri është shtënë në drejtim të tani të ndjerës Liridona Ademaj.

Natyrisht, gjykata e shkallës së parë, një konkludim të tillë e ka aprovuar, pasi më parë ka bërë vlerësimin e provave në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 1 dhe 2, kurse, për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 369 par.7 të KPPRK-së, ku, përveç, deklaratës së vet të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, deklarata këto të dhëna në polici, prokurori por, edhe në shqyrtimin gjyqësor, ka marrë parasysh, sidomos, edhe deklaratat e dëshmitarëve - të dëmtuarit Leonard Ademaj, dëshmitarëve Jeton Binaku, Hasan Hasanaj, Naim Sadiku, Florian Avdija, Aurel Pajaziti dhe Kanun Kokalla, deklarata këto nga të cilat vërtetohet se i akuzuari Naim Murseli me tani të ndjerën Liridona Ademaj, nuk ka pasur raporte të mira bashkëshortore, ndërsa, nga vetë deklaratat e të akuzuarve, kuptohet, pjesërisht, e sidomos, deklarata e të akuzuarit Granit Plava, vërtetohet se si kanë biseduar me të akuzuarin Naim Murseli, që ta bëjnë planin për privimin nga jeta tani të ndjerës Liridona Ademaj, ku, për këtë të akuzuarin Granit Plava, i është premtuar shpërblim në shumë prej 30.000 (tridhjetë mijë) €, me të kryer veprën penale në fjalë, e më pastaj, edhe shuma tjera përkitazi me mbajtjen e familjes së të akuzuarit Granit Plava, pastaj, punësim, por, edhe shpërblime tjera të mëtutjeshme, kuptohet, pasi që i akuzuari Granit Plava, të dal nga burgu, ku, përkitazi me këtë kanë biseduar edhe për mënyrën e inskenimit të një aksidenti, por, për këtë nuk janë pajtuar, e pastaj, për mënyrën se si do të ndodhë vrasja, pra, si të veprojnë, kanë vizituar disa herë lokacionin, ku, gjendet shtëpia e të akuzuarit Naim Murseli dhe ditën kritike, pra, sipas deklaratave në fjalë edhe ka ndodhur vrasja e tani të ndjerës, mirëpo, sipas të akuzuarit Granit Plava, në momentin kritik këtë e ka bërë vetë i akuzuari Naim Murseli, e jo, i akuzuari Granit Plava, duke u arsyetuar se detyra e tij ka qenë vetëm marrja e armës nga i akuzuari Naim Murseli dhe fshehja e armë në fjalë, por, që pra, nuk e kontestón prezencën në vendin e ngjarjes, e që për faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, nuk ia falë besimin të akuzuarit Granit Plava, duke u bazuar edhe në provat materiale në shkresa të lëndës, sidomos, edhe të ekspertizës së balistikës, ku, vërtetohet se me armën me të cilën është privuar nga jeta tani e ndjera Liridona Ademaj, është gjetur

dhe sekuestruar nga i akuzuari Granit Plava, e ku, nga ekspertiza në fjalë është vërtetuar se predha e gjetur në vendin e ngjarjes, për të cilën është vërtetuar se me të njëjtën është privuar nga jeta tani e ndjera, është shtënë nga arma e cila është gjetur tek i akuzuari Granit Plava, e që, me këtë, është vërtetuar se pikërisht i akuzuari Granit Plava, është personi që ka shtënë në drejtim të tani të ndjerës Liridona Ademaj. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se në momentin kritik, kur, është shtënë në drejtim të tani të ndjerës Liridona Ademaj, në vendin e ngjarjes, gjegjësisht, në automjet, në të cilin është privuar nga jeta tani e ndjera Liridona Ademaj, ka qenë edhe i akuzuari Naim Murseli dhe atë, së bashku edhe me dy fëmijët e tij, ku, në atë, moment, pra, sipas deklaratës së të dëmtuarit Leonard Ademaj, por, edhe ekspertizës së mjekësisë ligjore është vërtetuar se i akuzuari Naim Murseli, në momentin kur, ka shtënë me armë i akuzuari Granit Plava, i njëjti, pra, i akuzuari Naim Murseli, e ka mbajtur me dorë tani të ndjerën Liridona Ademaj dhe atë, duke e kapur për krahu, krejt kjo me qëllim që e shtëna me armë të jetë e saktë, ku, edhe i akuzuari Granit Plava me një të shtënë e ka privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, e që me këtë, tek ky i akuzuar, pra, i akuzuari Naim Murseli, plotësohet edhe elementi i dinakërisë, ngase, i akuzuari në fjalë, përveç, që e ka sjellë tani të ndjerën në vendin e ngjarjes, të njëjtën edhe e ka mbajtur për krahu e me qëllim që i akuzuari Granit Plava, ta realizojë vrasjen në mënyrë më të sigurte dhe të arrijë qëllimit të tije, pra, qëllimin e të akuzuarit Naim Murseli, pra, që ta eliminojë tani të ndjerën nga jeta e tij. Po ashtu, nga deklarata e të akuzuarit në fjalë, pra, të akuzuarit Granit Plava, por, pjesërisht, edhe të akuzuarin Naim Murseli, vërtetohet se gjatë bisedave të tyre për privimin nga jeta tani të ndjerës, ka qenë prezent edhe i akuzuari Kushtrim Kokalla, që do të thotë se ka marr pjesë në bisedat e tyre për përgatitjen e planit për vrasjen e tani të ndjerit Liridona Ademaj, pra, kuptohet përveç, që i njëjti ia ka gjetur të akuzuarit Naim Murseli, personin që do ta kryej vrasjen e tani të ndjerës, i njëjti, pra, i akuzuari Kushtrim Kokalla, ka qenë prezent në disa nga bisedat e tyre edhe për mënyrën e vrasjes, dhe atë, sidomos, kur, është folur edhe për inskenimin e aksidentit, për çka, këtë mënyrë të privimit nga jeta të tani të ndjerës Liridona Ademaj e ka refuzuar i akuzuari Granit Plava, prandaj, edhe me të drejtë është konstatuar se të gjithë të akuzuarit e kanë kryer veprën penale me dashje, dhe atë, dashje direkte, për ta privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj - bashkëshorten e të akuzuarit Naim Murseli, pra, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë kështu vlerësimin e provave kontradiktore, pra, ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, përveç, në dispozitiv që ka përfshirë të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet në mes të akuzuarit Naim Murseli dhe tani të ndjerës Liridona Ademaj dhe mënyrën sesi ka ardhur tek privimi nga jeta i tani të ndjerës Liridona Ademaj, edhe në arsyetim ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe atë, duke u mbështetur, përveç, në deklaratat e dëshmitarëve, pastaj, vetë të akuzuarve, kuptohet pjesërisht, ka marr parasysh edhe provat materiale, që do të thotë se me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, se bëhet fjalë për vrasje të rëndë në bashkëkryerje e të kryer me dashje direkte, e jo, sikur që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve, se veprat penale në fjalë nuk janë kryer nga të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, për çka, pra, në këtë drejtim, përkitazi me atë, se përse ka konkluduar se pikërisht të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, janë personat që kanë privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, kuptohet në bashkëkryerje, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsyera të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve vendimtare në këtë çështje penale - juridike, sikurse, të njëjtën gjë e ka bërë edhe për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, kur, ka konstatuar se i njëjti ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, dhe atë, duke marr parasysh për këtë të akuzuar se, përveç, që e ka njoftuar të akuzuarin Naim Murseli, i akuzuari Kushtrim

Kokalla, edhe ka propozuar të akuzuarin Granit Plava, si personi më i përshtatshëm për ta privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj dhe se në vijim gjatë bisedimeve në mes të akuzuarit Naim Murseli dhe të akuzuarit Granit Plava, ka marrë pjesë edhe vetë i akuzuari Kushtrim Kokalla, e që konkretisht kjo ka ndodhur kur, edhe është biseduar në mes tyre inskinimi i një aksidenti në komunikacion si mënyrë për privimin nga jeta tani të ndjerës, mirëpo, i akuzuari Granit Plava, nuk është pajtuar në këtë mënyrë për çka, më pastaj, kanë vazhduar bisedimet për mënyrat tjera, e që edhe ka ndodhur, pra, duke inskenuar rastin e grabitjes, që do të thotë se tek i akuzuari Kushtrim Kokalla, plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, ngase, ky i akuzuar përveç, tjerave ka ndihmuar në përgatitjen e planit, gjegjësisht, dhënien e udhëzimeve dhe këshillave se si të kryhet vepra penale, pra, vrasja e tani të ndjerës Liridona Ademaj.

Prandaj, përveç, që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i dyshimtë ose i pavërtetuar dhe përveç, që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsyera të qarta për vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu, edhe për mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga të akuzuarit, ku, përkitazi, me faktet dhe rrethanat ne fjale, se pari ka marr parasysh vetë deklaratat e të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, të cilët në mbrojtjen e tyre kanë mohuar kryerjen e veprave penale por, jo faktet dhe rrethanat, pra, se të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava se si ishin së bashku në vendin e ngjarjes, kur, është privuar nga jeta tani e ndjera Liridona Ademaj, pastaj, përmes provave materiale janë vërtetuar takimet e tyre dhe atë, përveç, nga lëvizjet e automjeteve të tyre edhe nga deklaratat e të akuzuarit Granit Plava, ku, nuk kontestohen takimet e tyre me të akuzuarin Naim Murseli, e që ky i akuzuar, pra, i akuzuari Granit Plava, nuk konteston as takimet me të akuzuarin Kushtrim Kokalla e sidomos, rastin në takimet kur është folur edhe për inskenimin e aksidentit si mënyrë për privimin nga jeta të tani të ndjerës Liridona Ademaj, e që ka qenë propozim konkret i të akuzuarit Kushtrim Kokalla, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar edhe veprimet inkriminuese të akuzuarit Kushtrim Kokalla, që kanë të bëjnë me veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga dy të akuzuarit e parë, për çka, edhe ky i akuzuar, pra, i akuzuari Kushtrim Kokalla, më pas është shpallur fajtor dhe është gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, prandaj, konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, me dashje direkte e kanë privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, duke kryer kështu vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari Naim Murseli, ndërsa, vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, i akuzuari Granit Plava, kurse, i akuzuari Kushtrim Kokalla, për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, janë të drejta, të arsyeshme dhe të bazuara në prova dhe shkresa tjera të lëndës. Gjithashtu, kjo gjykatë pati parasysh edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë, nuk ka pasur të drejtë të bazohet në deklaratën e të akuzuarve të dhëna në polici, pra, duke aluduar se deklaratat në fjalë janë prova të papranueshme, mirëpo, pretendimet në fjalë kjo gjykatë i vlerëson si të pa bazuara, ngase, gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme edhe në këtë drejtim, duke sqaruar se bëhet fjalë për deklaratat e të akuzuarve të dhëna në polici në mënyrë të rregullt e në prezencë të mbrojtësve të tyre dhe

se aktgjykimi i ankimuar nuk mbështetet vetëm në deklaratat e dhëna në polici, por, edhe deklaratat e dhëna në fazat e më vonshme, si në prokurori edhe në shqyrtimin gjyqësor, pra, duke marr parasysh edhe kontraditat në mes tyre, pra, ndryshimet që i kanë potencuar të akuzuarit por, edhe mbrojtja e tyre, pastaj, aktgjykimi mbështetet edhe në deklaratat e dëshmitareve të tjerë, por, edhe provat materiale të cekura më detajisht edhe në arsyetimin e kësaj gjykate, prandaj edhe në këtë drejtim pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve janë të pa bazuara, e të paargumentuara, për çka, edhe kjo gjykatë i vlerëson si të pa bazuara, e që, më në detaje është deklaruar gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e sajë, gjatë refuzimit të kërkesës për kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës.

Po ashtu, kjo gjykatë pati parasysh edhe pretendimet tjera ankimore gjegjësisht, propozimet e refuzuara të palëve, që kanë të bëjnë me propozimin për rikonstruimin e vendit të ngjarjes, pastaj, super ekspertizë për gjendjen e aftësisë mendore të dy të akuzuarve Naim Murseli dhe Granit Plava, për shikimin e video incizimeve përkitazi me komunikimin e fëmijëve nga Suedia, pra, është fjala për fëmijët e të akuzuarit Naim Murseli, mirëpo, të njëjtat i vlerëson të pabazuara të pa argumentuara për arsye se, gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kur i ka refuzuar propozimet në fjalë, ngase, gjendja faktike në këtë çështje penalo-juridike është vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe si rezultat i vërtetimit të fakteve dhe rrethanave në fjalë, edhe ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar dhe atë, duke përfshirë këtë për secilin të akuzuar veç e veç, pra, në tre dispozitivat, si për të akuzuarin Naim Murseli, pastaj, të akuzuarin Granit Plava por dhe të akuzuarin Kushtrim Kokalla, prandaj, edhe e njëjta - pra, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë nuk ka aprovuar një propozim të tillë, pra, për rikonstruimin e vendit të ngjarjes, sikur që këtë nuk e ka bërë as për super ekspertizë, ngase, përkitazi me aftësinë mendore të akuzuarve, pra, të akuzuarve Naim Murseli dhe Granit Plava, si në kohën e kryerjes së veprës penale, por, edhe tani përkitazi me gjendjen e tyre për pjesëmarrje në seancën e shqyrtimit gjyqësor, pra, gjykata e shkallës së parë, përveç, që ka marr parasysh ekspertizën e psikiatrisë në shkresa të lëndës, po ashtu, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka dëgjuar edhe ekspertët e kësaj lamie, të cilët i kanë sqaruar në detaje faktet dhe rrethanat në fjalë edhe me deklarata plotësuese të tyre, e po ashtu, nuk ka aprovuar propozimin për shikimin e video incizimeve përkitazi me komunikimet e fëmijëve nga Shteti i Suedisë, duke mbrojtur dhe ruajtur në këtë mënyrë edhe personalitetin e fëmijëve të tani të ndjerë Liridona Ademaj, prandaj, edhe në këtë drejtim pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe se aktgjykimi i ankimuar nuk ka mbështetje në prova të papranueshme.

Prandaj, në bazë të cekurave si më lartë, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 10 e par. 2 nën par. 4 dhe 5 e lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 të KPPRK-së, sikur që pretendohet në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal si dhe gjetjet e kësaj gjykate.



Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me ankesa në esencë vetëm janë përsëritur pretendimet e njëjta ankimore të cekura tek baza ankimore shkelje esenciale e dispozitave të procedues penale, ku, në esencë, kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, e sidomos, kur merret parasysh se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se veprat penale nuk janë kryer nga të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla dhe se gjykata e shkallës së parë në mungesë të provave konkrete krejt gjendjen faktike e bazon në deklaratat e të akuzuarve të dhënë në polici, por, edhe në provat materiale, prova këto nga të cilat nuk vërtetohet asgjë në mënyrë konkrete në drejtim të veprave penale për të akuzuarit për të cilat janë shpallur fajtorë, pastaj, duke marr parasysh kundërthëniet e deklaratave të akuzuarve, pastaj, të dëshmitarëve, ku, dëshmitarët nuk vërtetojnë faktet dhe rrethanat që i kanë parë në mënyrë të drejtë për drejtë, por, të gjithë bazohen vetëm në atë, çka kanë dëgjuar atëherë, nuk mund të konstatohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ku, në vijim të ankesave paraqitet përmbajtja e deklaratave të akuzuarve, dëshmitarëve, por, edhe përmbajtja e provave materiale në shkresa të lëndës, e duke konstatuar se me vetë faktin që gjykata e shkallës së parë, i ka shpallur fajtorë të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, për çka, edhe propozojnë që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penalo - juridike gjykata e shkalles se parë, ka vërtetuar se ditën kritike, për shkak të raporteve jo të mira bashkëshortore, i akuzuari Naim Murseli ka vendosur që ta privojë nga jeta bashkëshorten e tij - tani të ndjerën Liridona Ademaj dhe pasi më parë përkitazi me këtë bëjnë marrëveshje me të akuzuarin Granit Plava, se si ta privojë nga jeta tani të ndjerën, takohen disa herë në mes veti, kuptohet, pasi janë njoftuar në mes veti, përmes të akuzuarit Kushtrim Kokalla edhe e bëjnë planin e detajuar, për privimin nga jeta të tani të ndjerës Liridona Ademaj, i akuzuari Naim Murseli së bashku me tani të ndjerën Liridona Ademaj dhe dy fëmijët e tyre të përbashkët shkojnë me automjetin e tyre në vendin e ngjarjes, ku, aty, po i priste i akuzuari Granit Plava, dhe pasi iu del përpara me maskë, me qëllim që të duket se bëhet fjalë për grabitje, i akuzuari Granit Plava ofrohet tek automjeti, pra, në anën e tani të ndjerës Liridona Ademaj dhe ka shtënë me armën e tij të zjarrit në drejtim të tani të ndjerës Liridona Ademaj, kurse, në ndërkohë Naim Murseli, gjatë gjithë kohës, prej, kur e ka ndalur automjetin në rrugë, tani të ndjerën e mbante me dorën e tij përkrahu tani të ndjerën Liridona Ademaj, krejt këtë me qëllim që i akuzuari Granit Plava të jetë i saktë në të shtënat nga arma e zjarrit dhe pas kësaj i akuzuari Granit Plava e privon nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, ndërsa, i akuzuari Naim Murseli me dy fëmijët e tij largohet nga vendi i ngjarjes, e që, të njëjtën gjë, e bënë edhe i akuzuari Granit Plava, e që gjithë këtë e kanë bërë me ndihmën e të akuzuarit Kushtrim Kokalla, ku, ky i akuzuar më parë, ia ka gjetur të akuzuarin Granit Plava si personi që mund ta kryejë vrasjen e tani të ndjerës Liridona Ademaj, e që më parë, edhe ka marr pjesë në takimet e tyre të përbashkëta gjatë përgatitjes së planit për vrasjen e tani të ndjerës, duke iu dhënë edhe këshilla se si të bëhet plani për vrasjen e tani të ndjerës Liridona Adema, fakte këto dhe rrethana që vërtetohen përveç, pjesërisht nga vetë deklaratat e të akuzuarve dhe nga deklaratat e dëshmitarëve por, edhe provat materiale në shkresa të lëndës, të cilat më në detaje u cekën më lartë, tek baza ankimore shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, për çka, gjykata e shkallës së parë,

me të drejtë ka konstatuar se pa dyshim se vërtetohet se të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, me dashje direkte e kanë privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, ndërsa, i akuzuari Kushtrim Kokalla, po ashtu, ka ndihmuar dy të akuzuarit në kryerjen e veprës penale të vrasjes në fjalë. Po ashtu, përveç, vetë deklaratave të akuzuarit Granit Plava, edhe në provat materiale në shkresa të lëndës vërtetohet se të akuzuarit Granit Plava i është gjetur dhe sekuestruar në shtëpinë e tij arma e zjarrit e llojit dhe tipit të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar e që përkitazi me këtë i njëjti-pra, i akuzuari Granit Plava është shpallur fajtor dhe është gjykuar, që do të thotë se edhe përkitazi me këtë vepër penale nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit Granit Plava, kur, i njëjti është shpallur fajtor dhe është gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura, si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, janë kryerës të veprave penale dhe atë; i akuzuari Naim Murseli, i veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa, i akuzuari Granit Plava, i veprës penale vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 6 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPPRK-së, si dhe i akuzuari Kushtrim Kokalla, i veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 3 dhe 4 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, janë të drejta dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprave penale për të cilat të akuzuarit edhe janë shpallur fajtorë dhe janë gjykuar, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve, sikur që pretendojnë mbrojtësit e të akuzuarve, kur, të akuzuarit në fjalë, janë shpallur fajtorë dhe janë gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, përfaqësuesit e autorizuar të palës së dëmtuar, av. Leutrim Syla dhe mbrojtësve të akuzuarve, av. Shemsedin Pira, av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj, nuk janë të bazuara.

Në ankesën e prokurorisë përkitazi me këtë bazë ankimore pra, vendimin për dënim dhe atë, vetëm sa i përket të akuzuarit Kushtrim Kokalla, pretendohet se dënimi i shqiptuar për këtë të akuzuar është i butë, sidomos, nëse merret parasysh roli i tij aktiv në kryerjen e veprës penale, gjë, që është shprehur veçanërisht në seancën kryesore të mbajtur më datën 27.03.2026, kur, i akuzuari në mbrojtjen e tij ka paraqitur më shumë emocione negative ndaj tani të ndjerës Liridona Ademaj, duke e shprehur në këtë mënyrë pajtimin e tij, me të akuzuarin Naim, pra, me qëllimin e tij për ta privuar nga jeta tani të ndjerën Liridona Ademaj, si dhe për ta ndihmuar vetë në kryerjen e kësaj vepre penale, prandaj, sikur të mos ishin veprimet e Kushtrim Kokallës, shtrohet pyetja nëse i akuzuari Naim, do të mund ta bënte vetë këtë dhe ta angazhonte Granit Plavën, të cilin - pra, të akuzuarin Granit Plava, ia ka gjetur personalisht, i akuzuari Kushtrim Kokalla, për çka, propozon ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla, dhe të njëjtit t'i shqiptojë dënim me burgim të përjetshëm.

Në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av. Leutrim Syla, përkitazi me këtë bazë ankimore, pra, për të akuzuarin Kushrim Kokalla, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike si dhe në mënyrë të drejtë ka vendosur kur, të akuzuarit i ka shpallur fajtorë për veprat penale si në dispozitiv dhe gjithashtu, drejtë ka aplikuar dispozitat për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, mirëpo, një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, ngase, në mënyrë jo të drejti i ka aplikuar dispozitat për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për këtë të akuzuar. Në rastin konkret gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, të akuzuarit Kushtrim Kokalla, i ka shqiptuar dënim të ulët, i cili nuk është në proporcion me veprën e kryer nga ana e të akuzuarit, sidomos, kur nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha rrethanat rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Sipas pretendimeve në fjalë, edhe pse gjykata ka cekur faktin se i akuzuari Kushtrim Kokalla, ka ndihmuar në gjetjen e vrasësit, i cili ka vrarë një grua të re në sytë e dy fëmijëve për motive shumë të ulëta si dhe faktin se i akuzuari ka qenë pjesëtar i FSK-së, e që ka qenë i thirrur në mbrojtjen e jetës së qytetarëve dhe të ofrojë siguri për ta e jo të përfshihet në vrasjet makabre, prapë se prapë rrethanat në fjalë nuk i ka vlerësuar në mënyrë reale edhe pse kanë qenë fakte të mjaftueshme që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm. Më tutje, në ankesë vazhdohet me elaborimin e rrethanave rënduese si, rolin e të akuzuarit në planifikimin dhe organizimin e veprës penale, pjesëmarrjen e tij në takime për dakordimin për vrasje, pastaj, sjellja e të akuzuarit në gjykatore, por, edhe rrethana tjera e që më në detaje janë përshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar e duke propozuar ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar dhe të akuzuarit në fjalë, pra, të akuzuarit Kushtrim Kokalla, t'i shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm.

Në ankesën e përbashkët të mbrojtësve të akuzuarit Naim Murseli, av. Shemsedin Pira dhe av. Teuta Zhinipotoku, përkitazi me këtë bazë ankimore, për të akuzuarin Naim Murseli pretendohet se gjykata e shkallës së parë, ka shqiptuar dënim të ashpër, edhe përkundër faktit se gjykata ka marr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së. Në këtë çështje, gjykata nuk ka mundur ta gjejë asnjë rrethanë lehtësuese për të akuzuarin Naim Murselin, ndërsa, si rrethana rënduese ka marr shkallën e lartë të dashjes, se viktima - tani e ndjera ka qenë e re, se e njëjta ishte e pa mbrojtur, se është vrarë në sytë e fëmijëve të sajë, se e ndjera ishte nënë e re dhe ka lënë dy fëmijë të mitur, e duke i shqiptuar kështu dënim me burgim të përjetshëm. Sipas mbrojtësve të akuzuarit Naim Murseli, av. Shemsedin Pira dhe av. Teuta Zhinipotoku, duke pasur parasysh shkelje të shumta të elaboruara në këtë ankesë, atëherë, aktgjykimi në fjalë duhet të anulohet dhe në kuptim të vendimit për dënim, mirëpo, nëse Gjykata e Apelit, konsideron se nuk qëndrojnë shkeljet e cekura si më lartë, pra, për bazat tjera ankimore, atëherë, aktgjykimin e ankimuar e kundërshtojmë edhe për shkak të shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm, e duke propozuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë, sidomos, kur, i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë, e që, edhe me një dënim më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Granit Plava, av. Skender Gojani, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se edhe nëse nuk aprovohen pretendimet ankimore përkitazi me bazat tjera, pra, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhje jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, atëherë, edhe vendimi mbi dënim është i paligjshëm dhe nuk mund të qëndrojë dhe atë, sidomos, shqiptimi i dënimit me burgim të përjetshëm, sidomos, me arsyetimin ekzistues që e ka paraqitur gjykata e shkallës së parë. Përkitazi me këtë, gjykata e shkallës së parë konstaton se nuk ka gjetur rrethana lehtësuese, kurse, në procesverbal dokumenton tre fëmijë, gjendje të varfër ekonomike, punë jo të rregullt dhe mungesën e dënimeve të

mëparshme, që do të thotë se ka edhe rrethana lehtësuese që gjykata e shkallës së parë, nuk i ka marr parasysh, pastaj, nëse analizohet me seriozitet alternativa e paraparë deri në 35 vjet, atëherë, nuk kemi shpjegim se rehabilitimi është i pamundur përmes shqiptimit të një dënimi me burgim me afat të caktuar e jo me burgim të përjetshëm. Po ashtu, kur, është fjala për rrethanat rënduese të njëjtat nuk ndahen nga ato që cekën për të akuzuarin Naim Murseli, duke veçuar këtu vetëm një rrethanë dhe atë shkuarjen e të akuzuarit në diskotekë dhe mungesën e keqardhjes, e që kjo nuk mund të jetë bazë e mjaftueshme për shqiptimin e burgimit të përjetshëm, prandaj, nëse Gjykata e Apelit, nuk i aprovon bazat tjera ankimore atëherë, gjithsesi, duhet të ndryshohet vendimi për dënim, ashtu që, dënimi me burgim të përjetshëm t'i zëvendësohet me dënim me burgim me afat të caktuar.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Kushtrim Kokalla, av. Ndrecë Dodaj, përkitazi me këtë bazë ankimore, pra, vendimin për dënim, nuk është thënë asgjë konkretisht, duke konsideruar se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, prandaj, në këtë drejtim edhe vendimi për dënim është i kundërligjshëm, për çka, i njëjti propozon që i akuzuari të lirohet nga akuza apo edhe aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara e në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarve, për veprat e kryera penale e në të cilat thirren në arsyetimin e aktgjykimit dhe duke i vlerësuar të njëjtat përkitazi me pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar av. Leutrim Syla dhe mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, av. Shemsedin Pira, av. Teuta Zhinipotoku, av. Skender Gojani dhe av. Ndrecë Dodaj, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, av. Leutrim Syla, se dënimi i shqiptuar për të akuzuarin Kushtrim Kokalla, është i butë, gjegjësisht, i mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, se dënimi i shqiptuar për të akuzuarit Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, është i ashpër.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe atë konform dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ku, si rrethana rënduese ka marr shkallën e lartë të dashjes, pra, vendosmërinë për kryerjen e veprave penale, për të gjithë të akuzuarit, motivin e kryerjes së veprës penale për të akuzuarin Naim Murseli, pra, i njëjti këtë e ka bërë edhe me qëllim të përfitimit material, mënyrën e kryerjes së veprës penale - për të akuzuarit Naim Murseli dhe Granit Plava, ku, të njëjtit veprën penale e kanë kryer në praninë edhe të dy fëmijëve të tani të ndjerës Liridona Ademaj, për të gjithë të akuzuarit pastaj, se e ndjera ka qenë e moshës së re, se vepra penale është kryer ndaj viktimës së pa mbrojtur, pastaj, sjelljet e të akuzuarve para dhe pas kryerjes së veprës penale, ku, para kryerjes së veprës penale të akuzuarit e bëjnë planifikimin e detajuar se si ta privojnë nga jeta tani të ndjerën, ndërsa, pas kryerjes së veprës penale të akuzuarit vazhdojnë me aktivitetet e tyre edhe të argëtimit, duke shkuar pra në lokale, pra, pa treguar aspak dhimbje për tani të ndjerën dhe në prezencën e rrethanave në fjalë, të akuzuarve iu ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore - DKR në Prishtinë, dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, përkitazi me të akuzuarin Kushtrim Kokalla, nuk qëndrojnë ngase, gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit Kushtrim Kokalla i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vjet, ashtu, sikur që edhe lejohet me dispozitat e KPRK-së, ngase, për rastet e kryerjes së veprës penale në ndihmë, dispozita në fjalë shprehimisht parasheh se në rastet e ndihmës kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënim më i butë se sa kryerësit të veprës penale, prandaj, në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë, edhe nuk ka pasur mundësi që të akuzuarit Kushtrim Kokalla t'i shqiptojë dënim me burgim të përjetshëm, për çka, edhe u refuzuan ankesat e prokurorisë dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar si të pabazuara. Po ashtu, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve Naim Murseli, Granit Plava dhe Kushtrim Kokalla, se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarve në fjalë iu ka shqiptuar dënim të ashpër, për arsye se e njëjta - pra, gjykata e shkallës së parë, para se të shqiptojë një dënim të tillë, pra, dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar dhe atë, të akuzuarve Naim Murseli dhe Granit Plava, dënim me burgim të përjetshëm, kurse, të akuzuarit Kushtrim Kokalla dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vjet, ka marr parasysh të gjitha rrethanat rënduese që ekzistojnë për të akuzuarit, e sidomos, edhe pasojën e veprës penale, kur, në rastin konkret është privuar nga jeta një viktimë e pambrojtur, nënë e dy fëmijëve, e moshës së re, e po ashtu, është privuar nga jeta edhe në prezencën e dy fëmijëve të sajë, pastaj, vepra penale në fjalë është kryer nga i akuzuari Naim Murseli, është kryer edhe me qëllim të përfitimit material, prandaj, duke marr parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, - pra, në prezencën edhe të dy fëmijëve, e sidomos, vendin dhe kohën e kryerjes së veprës penale - pra, në afërsi të shtëpisë së banimit e në rrugë publike, pastaj, sjelljen e të tre të akuzuarve para dhe pas kryerjes së veprës penale, e me këtë edhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, kjo gjykatë, konsideron se dënimi të cilin iu ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarve është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se, i njëjti është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës të kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Gjykata e Apelit, pati parasysh edhe pretendimet ankimore se tek të akuzuarit në fjalë ka edhe rrethana lehtësuese, e që konkretisht cekën disa nga rrethanat lehtësuese në fjalë, mirëpo, duke pasur parasysh pasojën e veprës penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, atëherë, rrethanat lehtësuese në fjalë në raport me ato rënduese janë irelevante, për çka, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë të njëjtat nuk i ka marr parasysh dhe ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.480/2026, më 29.10.2026

Procesmbajtës,
Riad Merovci

Anëtarët e kolegjit,
1.Xhevdet Abazi
2. Arben Hoti

Republika e Kosovës / Republika Kosovo

Kryetar i kolegjit,
Mentor Hajraj

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašceni radnik

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqitet nga palët në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës, përmes gjykatës së shkallës së parë.